# EPOKA E RE

E përditshme e pavarur
Viti XIX, nr. 5840
E martë, 30 korrik 2019
çmimi 0.40 €


## MTI-ja obligon kompanitë që shesin derivate t'i pastrojnë rezervuarët

FAQE 9




Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com
facebook.com
Gazeta "Epoka e re"



AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de


FLET PËR "EPOKËN E RE", DRITON ÇAUSHI FAQE 4-5

# Besojmë fuqishëm se do të dalim mirë në zgjedhje



Deputeti i Partisë Socialdemokrate (PSD), Driton Çaushi, ka vlerësuar se ky subjekt politik deri më tani ka arritur të paraqesë një model të ri të politikëbërjes në vend. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka deklaruar se këtë model PSD-ja e ka treguar me qeverisjen e mirë të saj në Prishtinë dhe Kamenicë dhe me aktivitetin e grupit të saj parlamentar. Sipas Çaushit, i vetmi ka qenë grupi parlamentar i PSD-së i cili, pos kritikës, çdoherë ka dhënë edhe alternativa për zgjidhjen e problemeve. Ai ka thënë se këto punë e bëjnë PSD-në të besojë fuqishëm se do të dalë mirë në zgjedhjet e parakohshme parlamentare. Driton Çaushi ka theksuar se PSD-ja nuk do të bëjë asnjë diskutim për koalicion me PDK-në

## OPINION

TRI GJËRA PËR TË CILAT NUK DUHET FOLUR NË FUSHATË F. 8



Shkruan: Vigan QORROLLI

## AKTUALE

VESELI VAZHDON TAKIMET MOBILIZUESE ME DEGËT PËR ZGJEDHJET E REJA F. 7

NË QKUK FILLON VLERËSIMI I RREZIKSHMËRISË NË PUNË F. 8

## EKONOMI

PUNËTORËT E TELEKOMIT HYJNË NË GREVË, KUNDËRSHTOJNË KONTRATËN E RE ME 'Z-MOBILE' F. 9

BANKA BOTËRORE NË PËRGATITJE TË NJË PROJEKTI TË RI NË KOSOVË QË PËRMIRËSON FURNIZIMIN ME UJË F. 9



# Haradinaj: Nuk do të lejojmë vakum institucional

Kryeministri në dorëheqje, Ramush Haradinaj, ka treguar arsyet pse i është drejtuar të hënën Gjykatës Kushtetuese për interpretim të aktit të dorëheqjes së tij nga posti i kryeministrit. Ai ka bërë me dije se nga Kushtetuesja ka kërkuar sqarim për situatën juridike të krijuar pas dorëheqjes në mënyrë që të shmanget vakumi institucional. Megjithatë, Haradinaj i ka siguruar qytetarët e Kosovës se nuk do të lejojë vakum institucional deri në ardhjen e qeverisë së re FAQE 3

## KULTURË

DEMONSTRATAT QË E TRONDITËN JUGOSLLAVINË E TITOS F. 20

Mr. Sheremet KRASNIQI

## Gjykata Kushtetuese: Vendimet e presidentit për anëtarët e KQZ-së janë kushtetuese

FAQE 3



## SPORT

FERONIKELI BESON NË KUALIFIKIM F. 18




RENOVA PUTZ
Maqedoni
Xhepçisht –Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101, 044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan , Magj.Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

## Rama sot mban konferencë me gazetarë

Tiranë, 29 korrik - Kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, përmes zyrës së tij të shtypit ka njoftuar se sot (e martë) do të mbajë një konferencë me gazetarë në sallën e hartave. Sipas në njoftimit të kryeministrisë, 10.00, shefi i qeverisë në orën ka lajmëruar bashkëbisedim me gazetarët.

Madje, në njoftim kërkohet akreditimi i gazetarëve, çka nënkupton se ky takim i Ramës me gazetarët nuk është edhe fort i zakonshëm.

Shumë janë çështjet që pritet të diskutohen mes Ramës dhe gazetarëve, duke filluar nga ato më të fundit si "Teatri Kombëtar", apo edhe ato që lidhen me para dhe pas 30 qershorit.

Një vend të rëndësishëm në këtë komunikim pritet të ketë edhe për shkarkimin e Metës dhe ngritjen e institucioneve të reja të drejtësisë.

A ka negociata jopublike mes Ramës dhe Bashës, apo mes Ramës dhe Metës: A është tërhequr Rama nga përballja me drejtësinë, e atyre emrave që ka lakuar gjatë fushatës?

A do të veprojë drejtësia, pas ngritjes së gjykatës dhe prokurorisë speciale. Gjithashtu edhe një temë që nuk do të mbetet jashtë diskutimeve pritet të jetë 13 tetori, datë e dekretuar nga Meta për zgjedhjet lokale. Të gjitha këto do të jenë në diskutimet e Ramës me gazetarët.



# Në pritje të debatit presidencial të demokratëve

Debati i kësaj jave u ofron mundësi kandidatëve demokratë për president të flasin drejtpërdrejt me votuesin, gjë që ata do ta bëjnë në muajt e ardhshëm në tubime të vogla kudo në Shtetet e Bashkuara. Ish-nënpresidenti Biden kryeson qartë në anketa por, megjithatë, është në rënie




AP

Uashington, 29 korrik - Këtë javë në Detroit zhvillohet debati i dytë i kandidatëve demokratë për president. Analistët presin një përballje të ashpër mes garuesve. Sot (e martë) në skenë do të jenë kandidatët Bernie Sanders dhe Elizabeth Warren, ndërsa ish-nënpresidenti Joe Biden do të debatojë nesër (e mërkurë) dhe pritet që ai të përpiqet të shmangë sa më shumë sulmet nga garuesit e tjerë.

Ish-nënpresidenti Biden kryeson qartë në anketa, megjithatë është në rënie. Biden, bashkë me kandidatë të tjerë, vizituan javën që shkoi grupe afrikano-amerikane për të drejtat e njeriut.

Në qendër të vëmendjes ishin komentet e presidentit Donald Trump kundër katër ligjvënëseve me ngjyrë, që demokratët i quajnë komente raciste.

Gara presidenciale e demokratëve u ashpërsua në qershor, kur senatorja nga Kalifornia, Kamala Harris, pyeti Biden për të kaluarën e tij.

Goditje të ngjashme duhet të presim edhe në debatin që po vjen, thotë një analist për "Zërin e Amerikës". "Ky mund të jetë shansi i fundit për shumicën e 20 kandidatëve. Mënyra për ta bërë këtë është të jenë më agresivë dhe të sulmojnë ata që janë në krye të anketave", thotë Aaron Kall në Universitetin e Miçiganit.

Biden është sulmuar edhe për mbështetjen që i kishte dhënë në vitin 1994 një projektligji për krimet, i cili, sipas senatores Harris, çoi në burgosje masive të pakicave. Po këtë pyetje pritet ta parashtrojë senatori nga Nju Xhersi, Cory Booker. Por, një tjetër analist thotë se votuesit preferojnë të dëgjojnë për çështje ekonomike. "Mendoj se duhet të fokusohen në çështje si sigurimet shëndetësore, edukimi ose punësimi", thotë Michael Traugott nga Universiteti i Miçiganit.

Senatori nga Vermonti, Bernie Sanders, i cili radhitet i dyti në sondazhe, me vështirësi po udhëheq në anketa ndaj rivales Elizabet Warren, senatore nga shteti Masaçusets. "Na duhet një fushatë që i jep energji dhe e gjallëron popullin amerikan", tha senatori Sanders, kandidat demokrat për president.

Debati ua ofron mundësi kandidatëve të flasin drejtpërdrejt me votuesin, gjë që ata do ta bëjnë në muajt e ardhshëm në tubime të vogla kudo në Shtetet e Bashkuara.

## Vuçiqi falënderon Rusinë për ndihmat ushtarake

Beograd, 29 korrik - Në Serbi mbërriti kontingjenti i parë i ndihmave ushtarake nga Moska me tanke dhe mjete të blinduara, të cilat Rumania nuk i lejoi javën e kaluar të kalonin transit në territorin e saj për shkak të sanksioneve të BE-së ndaj Moskës. Presidenti serb Aleksandar Vuçiq falënderoi të hënën homologun rus Vladimir Putrin për modernizimin e ushtrisë së vendit të tij, por nuk pranoi të tregonte se si kishin mbërritur pajisjet ushtarake.

Ndihmat ushtarake nga Rusia për Serbinë kanë shkaktuar shqetësime në Perëndim se mund të rrezikojnë paqen e brishtë në Ballkan.

"Do ta përsëris për ata që nuk e dinë: armët janë dhuratë, mjete plotësisht moderne nga Rusia. Ne nuk kemi paguar për to. Rusia ka paguar për modernizimin e forcave dhe unë i falënderoj. Kjo e shton dukshëm aftësinë tonë ushtarake", tha ai.

Presidenti Vuçiq foli gjatë inspektimit të dhjetë mjeteve të blinduara ushtarake që mbërritën së fundmi në një bazë ushtarake serbe.

"Për ne është e rëndësishme që respektuam ligjet ndërkombëtare dhe arritëm të sillnim pajisjet ushtarake në territorin tonë. Si dhe në çfarë mënyre e bëmë, është puna jonë", tha ai.

Pajisjet ushtarake mbërritën me gjithë kundërshtimin e Rumanisë fqinje për të lejuar kalimin e tyre transit përmes lumit Danub për shkak të sanksioneve ndërkombëtare ndaj Moskës si rezultat i veprimeve të saj në Ukrainë.

Shtypi njofton se Rusia përdori aeroplanë transporti për dërgimin e pajisjeve ushtarake në Serbi.

Rusia e ka ndihmuar Serbinë t'i modernizojë forcat e saj të armatosura duke ngritur shqetësime për sigurinë në Ballkan.



Serbia ka marrë tashmë 6 aeroplanë luftarakë MiG-29 nga Rusia dhe ndonëse pretendon të jetë ushtarakisht neutrale, po negocion blerje të tjera armësh nga Moska, përfshirë helikopterë luftarakë dhe transporti si dhe sisteme të mbrojtjes ajrore.

EPOKA E RE

Botohet nga "Epoka e re" • Kryeredaktor: Mal QORRAJ
• Drejtor i përgjithshëm: Sadik ZEQIRI (Tel: 044 127 434, dhe 049 127 434 e-mail: sadikzeqiri@yahoo.com)
• ADRESA: Prishtinë, përballë ish-Selisë Qendrore të UNMIK-ut
• Tel: 038/227-557, e-mail: epokaere_mm@hotmail.com & mm_epokaere@yahoo.com

Kryeministri në dorëheqje, Ramush Haradinaj, i është drejtuar të hënën Gjykatës Kushtetuese

# Haradinaj: Nuk do të lejojmë vakum institucional

Kryeministri në dorëheqje, Ramush Haradinaj, ka treguar arsyet pse i është drejtuar të hënën Gjykatës Kushtetuese për interpretim të aktit të dorëheqjes së tij nga posti i kryeministrit. Ai ka bërë me dije se nga Kushtetuesja ka kërkuar sqarim për situatën juridike të krijuar pas dorëheqjes në mënyrë që të shmanget vakumi institucional. Megjithatë, Haradinaj ka siguruar qytetarët e Kosovës se nuk do të lejojë vakum institucional deri në ardhjen e qeverisë së re




EPOKA E RE Muhamet KOCI

PRISHTINË, 29 KORRIK - Kryeministri në dorëheqje, Ramush Haradinaj, të hënën ka dorëzuar në Gjykatën Kushtetuese kërkesën për interpretim e aktit të dorëheqjes së tij nga posti i kryeministrit të vendit dhe përcaktimin e kompetencave të qeverisë pas këtij akti. Në një konferencë për medie, ai ka thënë se qëllimi i kërkesës së tij është që të kërkohet sqarim për situatën juridike të krijuar pas dorëheqjes në mënyrë që të shmanget vakumi institucional. "Kam dorëzuar në Gjykatën Kushtetuese një kërkesë për interpretim të dorëheqjes sime. Se a nënkupton dorëheqje dhe një kujdestari qeverisëse, pra një vazhdim të kujdestarisë, edhe pse Zyra Ligjore pranë kryeministrisë e ka vlerësuar kështu në bazë të përvojave të mëhershme. Megjithatë, për të qenë në anën e ligjit, kam dërguar këtë kërkesë", ka thënë Haradinaj. Sipas tij, nuk duhet të lejohet vakumi institucional deri në qeverinë e re. "Nuk është se krejtësisht jeta ndalet në këtë periudhë kohore, por e shoh një dëshirë për t'i përzier temat. Unë kam dhënë dorëheqje, një qeveri duhet të dalë nga zgjedhjet, por derisa nuk vjen ajo qeveri, kush mban përgjegjësi? Këtë përgjigje nuk po e jep askush dhe unë nuk po guxoj ta lë vendin në kaos deri në zgjedhje, derisa të zgjedhjet një qeveri tjetër. Për këtë arsye iu kam drejtuar Gjykatës Kushtetuese. Megjithatë, i siguroj qytetarët e vendit se nuk do të lejojmë vakum institucional", ka deklaruar ai.

Haradinaj ka mohuar se kjo kërkesë mund të ndikojë në shtyrjen e zgjedhjeve të parakohshme parlamentare. Ai ka thënë se ka kërkuar nga të gjithë që zgjedhjet të shpallën sa më shpejt. "Jo, jo. Kam kërkuar nga presidenti, Kuvendi dhe nga partitë që t'i marrin vendimet e duhura dhe për t'i shpallur zgjedhjet në afatet e rregullta kohore. Partia ime mbështet shpërndarjen e Kuvendit dhe kjo nuk është për të ndërhyrë në afatet e zgjedhjeve", është shprehur ai, duke shtuar se ky interpretim i Kushtetueses do t'i qartësojë edhe situatat e ngjashme në të ardhmen. "Kjo bëhet që të krijohet shembull edhe për herët e ardhshme. Kushtetuta jonë nuk e ka precizuar se çfarë ndodhë kur kryeministri jep dorëheqje. Këtë nuk e bëj vetëm për vete, por edhe për të ardhmen. Duhet të kemi një kuadër ligjor se si duhet të veprojë qeveria në dorëheqje", ka thënë Haradinaj. Ai ka deklaruar se personalisht më nuk ka asnjë interes që pas dorëheqjes të vijë në zyrën e kryeministrit. Sipas Haradinajt, këtë po e bën për të mos lënë vakum institucional.

Ndër të tjera, Haradinaj ka treguar se për të martën ka ftuar në takim kryetarin e PDK-së, Kadri Veselin, atë të Nismës Fatmir Limajn dhe kolegët e tjerë të koalicionit për konsulta.

Kur është pyetur se çfarë do të diskutohet në këtë takim, Haradinaj, duke ironizuar, ka thënë se për njohjen globale. Sipas tij, takimet e tilla kanë qenë të rregullta. Haradinaj ka thënë se nuk i ndan rrugët me askënd që punon për Kosovën, duke shtuar se AAK-ja në këto zgjedhje synon të shkojë e vetme.

# Gjykata Kushtetuese: Vendimet e presidentit për anëtarët e KQZ-së janë kushtetuese

PRISHTINË, 29 KORRIK - Gjykata Kushtetuese e Kosovës ka vlerësuar se vendimet e presidentit të Kosovës për emërimin e anëtarëve të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve të Republikës së Kosovës janë në përputhje me Kushtetutën e vendit.

Në aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese, të publikuar në uebfaqen zyrtare të kësaj gjykate, thuhet se "vendimet për emërimet e anëtarëve të KQZ-së të 28 marsit 2019, të presidentit të Republikës së Kosovës, nuk janë në kundërshtim me paragrafin 4 të nenit 139 (Komisioni Qendror i Zgjedhjeve) të Kushtetutës".

Pas zgjedhjeve të vitit 2017, presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, e ka zvarritur emërimin e anëtarëve të rinj të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, me arsyetimin se e ka të paqartë se si duhet të veprojë pas rezultatit të këtyre zgjedhjeve.

Më pas, ai ka kërkuar mendimin e Gjykatës Kushtetuese se si duhej të vepronte.

Kjo e fundit e ka udhëzuar që të emërojë në KQZ dy kandidatë nga Lëvizja Vetëvendosje, dy kandidatë nga Lidhja Demokratike e Kosovës dhe dy kandidatë nga koalicioni parazgjedhor PAN (Partia Demokratike e Kosovës, Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës dhe Nisma Socialdemokrate).

Por, tri partitë e koalicionit PAN pretendonin të drejtën për nga një anëtar në KQZ dhe nuk i kanë dërguar emrat e kandidatëve të tyre te presidenti Thaçi.

Nisur nga kjo, ato i janë drejtuar për vlerësim Gjykatës Kushtetuese.

Kërkesën për vlerësimin e kushtetutshmërisë së vendimeve të presidentit për emërimin e anëtarëve të KQZ-së e kanë parashtruar Bilall Sherifi nga Nisma Socialdemokrate dhe 29 deputetë të tjerë të Kuvendit të Kosovës.




Aktualisht, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve i ka dy anëtarë më pak, por është vlerësuar se edhe pa ta është funksional dhe mund t'i organizojë zgjedhjet e parakohshme të mundshme.

Flet për "Epokën e re", Driton Çaushi

# Besojmë fuqishëm se do të

Deputeti i Partisë Socialdemokrate (PSD), Driton Çaushi, ka vlerësuar se ky subjekt politik deri më tani ka arritur të paraqesë një model të ri të politikëbërjes në vend. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka deklaruar se këtë model PSD-ja e ka treguar me qeverisjen e mirë të saj në Prishtinë dhe Kamenicë dhe me aktivitetin e grupit të saj parlamentar. Sipas Çaushit, i vetmi ka qenë grupi parlamentar i PSD-së i cili, pos kritikës, çdoherë ka dhënë edhe alternativa për zgjidhjen e problemeve. Ai ka thënë se këto punë e bëjnë PSD-në të besoj fuqishëm se do të dalë mirë në zgjedhjet e parakohshme parlamentare. Driton Çaushi ka theksuar se PSD-ja nuk do të bëjë asnjë diskutim për koalicion me PDK-në



EPOKA E RE Muhamet KOCI

PRISHTINË, 29 KORRIK - Deputeti i Partisë Socialdemokrate (PSD), Driton Çaushi, është shprehur i bindur se kjo parti do të dalë mirë në zgjedhjet e parakohshme që pritet të mbahen së shpejti. Ai ka bërë me dije se me shembullin e mirë të qeverisjes në Prishtinë dhe Kamenicë, si dhe me aktivitetin e grupit parlamentar, kanë arritur të paraqesin një model të ri të politikëbërjes në vend. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", Çaushi ka thënë se ky subjekt politik, krahas kritikës, çdoherë ka ofruar edhe alternativën e zgjidhjes së problemeve. "Kemi besim të fuqishëm se do të dalim shumë mirë nga ky proces zgjedhor. Kemi punuar gjithë vitin për shtrirjen, zgjerimin dhe forcimin e organizatës sonë në terren. Kemi dhënë shembullin më të mirë të qeverisjes në Prishtinë e Kamenicë. Si dhe, si grup parlamentar kemi qenë mjaft të angazhuar në Kuvendin e Kosovës, duke problematizuar e shtyrë përpara çështje që janë në interes të qytetarit të vendit. Si parti paraqesim një model të ri të politikëbërjes ku, krahas kritikës, ofrohet edhe zgjidhja e problemeve. Jam i bindur që ky është një model që e duan qytetarët", ka thënë Çaushi.

Deputeti i PSD-së ka treguar se pas dorëheqjes së kryeministrit e vetmja alternativë mbetet shkuarja sa më shpejt e vendit në zgjedhje. Ai ka deklaruar se janë të hapur për koalicione parazgjedhore, ani pse personalisht mendon se PSD-ja duhet të shkojë e vetme në zgjedhje.

Në lidhje me preferencat që AAK-ja dhe Nisma i kanë shprehur për të bërë koalicion me këtë subjekt politik, Çaushi ka bërë me dije se në rast të ndonjë bashkëpunimi për PSD-në prioritet është diskutimi mbi çështjet programore e jo postet politike. "Ne e kemi vullnetin dhe gatishmërinë që në rast të interesimit për koalicione, t'i shtrojmë si diskutim çështjet programore. Vetëm duke bërë një diskutim të këtillë mund të flasim tutje për ndonjë bashkëpunim më konkret. Duhet ta shtjerrim diskutimin për të parë se ku bëhemi bashkë me njëri-tjetrin dhe ku i kemi dallimet, e jo siç kemi parë më herët, ku koalicionet janë formuar duke pasur temë bosht se kush cilën pozitë po e merr", është shprehur ai, duke shtuar se vetëm me PDK-në nuk bëjnë asnjë diskutim për koalicion të mundshëm.

**"Epoka e re"**: *Z. Çaushi, si e ka*

# dalim mirë në zgjedhje



*pritur PSD-ja dorëheqjen e kryeministrit?*

**Çaushi:** Ishte befasi. Dorëheqja e tij erdhi kur po kërkohej më së shumti, por erdhi për një arsye krejt tjetër, pra për shkak të ftesës së tij në Hagë. Vetë ftesa ishte e habitshme sepse zoti Haradinaj tashmë është përballur me këtë proces gjyqësor. Unë, sikurse edhe kolegët në PSD, patëm dorëzuar nënshkrimet për ta rrëzuar qeverisjen e tij. Por, më vjen keq që kjo ndodhi për shkak të ftesës nga Specialja.

**"Epoka e re":** *Kushtetuta tani parasheh edhe mundësinë që koalicioni aktual të mund ta nominojë një kandidat tjetër për kryeministër. Duhet të provohet kjo mundësi apo duhet të thirret një seancë e jashtëzakonshme për shpërbërjen e Kuvendit?*

**Çaushi:** E kemi përsëritur disa herë si PSD që nga dita kur Haradinaj dha dorëheqje, se rruga e vetme tashmë janë zgjedhjet. Na duhet një qeveri që del nga një proces i zgjedhjeve të lira dhe demokratike, e nuk shoh asnjë arsye për manovrime të tjera. Jemi në pritje të shpalljes së datës së zgjedhjeve dhe jemi shumë të interesuar për një qeverisje funksionale pas përfundimit të këtij procesi.

**"Epoka e re":** *Kur është koha më e mirë për mbajtjen e këtyre zgjedhjeve dhe si pritni të dalë PSD-ja në këto zgjedhje?*

**Çaushi:** Nuk mund të flasim tani për data të preferuara. Është me rëndësi që të respektohet Kushtetuta dhe ligjet e vendit dhe presidenti t'i thërrasë takimet konsultuese me partitë për datën e zgjedhjeve. Aty japim edhe propozimet tona. Kemi besim të fuqishëm që do të dalim shumë mirë nga ky proces zgjedhor. Kemi punuar gjithë vitin për shtrirjen, zgjerimin dhe forcimin e organizatës sonë në terren. Kemi dhënë shembullin më të mirë të qeverisjes në Prishtinë dhe Kamenicë. Si dhe, si grup parlamentar kemi qenë mjaft të angazhuar në Kuvendin e Kosovës, duke problematizuar e shtyrë përpara çështje që janë në interes të qytetarit të vendit. Si parti paraqesim një model të ri të politikëbërjes ku, krahas kritikës, ofrohet edhe zgjidhja e problemeve. Jam i bindur se ky është një model që e duan qytetarët.

**"Epoka e re":** *PSD-ja preferon të shkojë e vetme në zgjedhje apo me ndonjë koalicion parazgjedhor?*

**Çaushi:** Për mua është e pëlqyeshme të shkojmë të vetëm në zgjedhje, por këtë vendim e marrin strukturat e partisë, pas një diskutimi të hollësishëm. Sidoqoftë, në rast të ndonjë bashkëpunimi e shoh si prioritar diskutimin mbi çështjet programore dhe pajtimin mbi to me partnerin e koalicionit.

**"Epoka e re":** *Tashmë AAK-ja dhe Nisma janë shprehur pro një koalicioni me PSD-në. Sa është i mundshëm një koalicion i tillë, dhe a ka vija të kuqe PSD-ja për ndonjë parti politike?*

**Çaushi:** Ne e kemi vullnetin dhe gatishmërinë që në rast të interesimit për koalicione, t'i shtrojmë si diskutim çështjet programore. Vetëm duke bërë një diskutim të këtillë mund të flasim tutje për ndonjë bashkëpunim më konkret. Duhet ta shtjerrim diskutimin për të parë se ku bëhemi bashkë me njëri-tjetrin dhe ku i kemi dallimet, e jo siç kemi parë më herët, ku koalicionet janë formuar duke pasur temë bosht se kush cilën pozitë po e merr. Pas kësaj mund të flasim se sa është i mundshëm ndonjë koalicion me këto dy parti. Në anën tjetër, mbajmë qëndrimin e mëhershëm që nuk bëjmë asnjë diskutim për koalicion e kurrfarë koalicioni me PDK-në, për të cilën, siç jemi shprehur edhe më herët, konsiderojmë që pas zgjedhjeve duhet të jetë në opozitë.

# TRI GJËRA PËR TË CILAT NUK DUHET FOLUR NË FUSHATË



**Shkruan: Vigan QORROLLI**

Për të qenë maksimalisht besnik ndaj fakteve, në fushatë zgjedhore nuk flitet me mençuri por, me andralla, prapësi, goditje, urrejtje dhe me premtime për hiçgjë.

Fushata zgjedhore, nga shkaku se është një marrëzi imagjinare, hamendësimi për të, në kontekstin e Kosovës, duhet të ndërtohet mbi tri gjëra të cilat nuk duhen përmendur gjatë saj:

**E para: Dialogu me Serbinë**

Dialogu me Serbinë dhe historiku i raporteve me shtetin dikur armik, që synohet të bëhet mik, nuk bën assesi të përdoret si slogan fushate ose si ambicie për të hipur në pushtet. Mallkimi i dialogut me shtetin armik-mik duhet të hidhet në koshin e plehrave dhe për këtë të flasë historia dhe jo politikanët shëtitës me patriotizëm të plagosur.

**E dyta: Zhvillimi ekonomik, sundimi i ligjit, shëndetësia**

Në 20 vjet liri dhe në 11 vjet republikë, kjo kastë politikanësh ka treguar mrekullisht se sa e padenjë është për zhvillimin ekonomik-shoqëror, për ruajtjen e pavarësisë dhe integritetit prokurorial/gjyqësor dhe sa e pasinqertë është për adresimin e nevojave bazike shëndetësore për qytetarët e vet.

Kjo katrahurë në këto tri fusha sublime për shpirtin e gjallë të njeriut kosovar, me kapje absolute dhe shkërmoqje të plotë të tyre, vërteton se mendja e kësaj elite politike është e lodhur, e gllabëruar dhe si një verë e prishur që nuk pihet, po kaq nuk duhet të votohet.

**E treta: Liberalizimi i vizave**

Nuk ka një temë që ngjallë më shumë neveri për njeriun kosovar sesa liberalizimi i vizave, rrjedhimisht udhëtimi i lirshëm drejt Unionit Evropian. Zemra e njeriut të rëndomtë është e brishtë por, ajo e një politikani, për të cilin dhembshuria nuk ekziston, është gjëja më e pamëshirshme kundrejt atyre që u shërben.

Duke mos qenë të aftë për sigurimin e mirëqenies për tjetrin (sall për veten dhe familjet e tyre), politikanët tanë nuk duhet të guxojnë kësaj radhe të flasin për "dhimbjen" e liberalizimit të vizave.

S'do mend, kjo temë është abuzuar së tepërmi dhe çdo gjë që flitet rreth saj duhet konsideruar (vetëm) si humor i rastit dhe asgjë tjetër përveç kësaj.

Liria politike, liria prej despotizmit është më e rëndësishmja e të gjitha vlerave politike (Karl Popper). Dhe populli ynë kësaj radhe duhet të luftojë për lirinë e tij politike. Nuk duhet që të rrijë duarkryq.

Në regjime despotike njerëzit janë në rrezik që ta tradhtojnë njerëzimin dhe ta humbasin njerzillëkun e tyre.

Nga ky shkak, shoqëria jonë, njerëzit tanë janë dehumanizuar. Moralisht, financiarisht, politikisht etj.

Për faj të regjimit, natyrisht.

# Filluan punimet në rrugën Babaj i Bokës - Korenicë

GJAKOVË, 29 KORRIK (ER) - Ministri Infrastrukturës dhe Transportit, Pal Lekaj, të hënën mori pjesë në fillimin e punimeve në rrugën Babaj i Bokës - Korenicë, e njohur si Rruga e Peshkut. Lekaj ka thënë se ky projekt që lidhë fshatrat e kësaj ane ka pritur shumë gjatë për t'u rregulluar dhe ndikon në zhvillimin e Komunës së Gjakovës. Kryetari i Gjakovës, Ardian Gjini, e ka falënderuar ministrin Lekaj për gatishmërinë e treguar për realizimin e këtij projekti dhe të gjitha të tjerave në Gjakovë. Rruga Korenicë - Babaj i Bokës është e gjatë 2.6 kilometra, kurse vlera e investimit nga Ministria e Infrastrukturës dhe Transportit është rreth 290 mijë euro.






# Një muaj paraburgim të dyshuarit që iu gjetën në banesë 2.4 kilogramë drogë

VUSHTRRI, 29 KORRIK (ER) - Prokuroria Themelore në Mitrovicë, Departamenti për Krime të Rënda, ka kërkuar nga Gjykata Themelore në Mitrovicë caktimin e paraburgimit për të dyshuarin F. S. nga Vushtrria për shkak të dyshimit të bazuar për kryerjen e veprave penale "Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve dhe substancave psikotropike dhe analoge" nga neni 267, paragrafi 1 i KPRK, "Prodhimi dhe përpunimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope, analoge apo veglave, pajisjeve apo materialeve narkotike" nga neni 268, paragrafi 1 o KPRK, si dhe "Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve" nga neni 366, paragrafi 1 i Kodit Penal të Republikës së Kosovës. Sipas kërkesës së prokurorisë të dorëzuar në gjykatë, ekziston dyshimi i bazuar se deri më 27 korrik 2019 i dyshuari në banesën e vet në Vushtrri pa autorizim është furnizuar me substancë narkotike në sasi prej 2 kilogramë e 400 gramësh të llojit marijuanë, e ndarë në nëntë qese në sasi të ndryshme, si dhe një qese në të cilat ishin farat e bimës së kanabisit me peshë prej 34.3 gramëve. Po ashtu gjatë kontrollit janë gjetur një palë pranga të ngjashme me të policisë, tetë copë fishekë, si dhe një sprej.

Gjyqtari i procedurës paraprake i Gjykatës Themelore në Mitrovicë, në seancën e mbajtur më 28 korrik, ka aprovuar kërkesën e Prokurorisë Themelore në Mitrovicë dhe i ka caktuar të dyshuarit F. S. masën e paraburgimit prej një muaji.

# Asfaltohet edhe një rrugë në Gurishtë të Malishevës

MALISHEVË, 29 KORRIK (ER) - Në kuadër të rregullimit të infrastrukturës rrugore në Komunën e Malishevës, të hënën në fshatin Gurishtë ka filluar asfaltimi i një rruge rreth 500 metra e gjatë, e cila lidhë një lagje me rrugët kryesore të fshatit. Fillimin e asfaltimit të rrugës e ka parë nga afër edhe nënkryetari i Komunës së Malishevës, Hajdin Berisha, i cili është takuar edhe me banorët e kësaj pjese të fshatit dhe me kryetarin e fshatit, Afrim Mazreku. "E gëzofshi rrugën e re, e cila për juve banorë të kësaj lagje ka rëndësi të madhe pasi, për shkak të thyerjes së terrenit, deri më tani e keni pasur problem qarkullimin për të shkuar me vetura në lagje. Ky nuk është projekti i vetëm, pasi në vazhdimësi dhe në të gjitha fshatrat do të vazhdojmë me investime konkrete, për ta përmirësuar mirëqenien dhe jetesën e të gjitha banorëve të Komunës së Malishevës", ka thënë nënkryetari i Komunës së Malishevës, Hajdin Berisha, gjatë vizitës në Gurishtë.

Ndërsa kryetari i fshatit Gurishtë, Afrim Mazreku, në emër të banorëve të kësaj lagje dhe të tërë fshatit, e ka falënderuar komunën për realizimin e këtij projekti, me shumë rëndësi për të gjithë banorët që jetojnë në këtë pjesë të fshatit, e të cilët deri më tani e kanë pasur problem qarkullimin me automjete dhe në shumë raste i kanë lënë automjetet shumë larg shtëpive për shkak të terrenit të thyer në këtë pjesë.





## Vihet gurthemeli për ndërtimin e shtëpisë për një familje egjiptiane në Pejë

PEJË, 29 KORRIK (ER) - Në kuadër të projektit të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS-së), që përfshin ndërtimin e 273 shtëpive, në më shumë se 20 komuna brenda Republikës së Kosovës, të hënën ministri Skender Reçica ka vënë gurthemelin për ndërtimin e shtëpive edhe për komunitetin pakicë në regjionin e Pejës, ku do të përfitojnë 30 familje. "Ky është një projekt që gëzon familjet e këtij komuniteti në Kosovë, që t'u japim përgjigje brengave të tyre, që të kenë familjet e sigurta me kulm mbi kokë. Pak ditë më parë vumë gurëthemelet e ndërtimit të shtëpive në Lipjan dhe do të vazhdojmë edhe në komunat e tjera. Ky është sinjali më i mirë që Republika e Kosovës, përkatësisht qeveria, do të vazhdojë të qëndrojë pranë qytetarëve që kanë nevojë", ka thënë Reçica.

# Veseli vazhdon takimet mobilizuese me degët për zgjedhjet e reja




EPOKA E RE Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 29 KORRIK - Pas pesë degëve që takoi të shtunën, kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Kadri Veseli, ka takuar të hënën edhe degë të tjera. Vitia, Kaçaniku, Vushtrria dhe Gjakova i konfirmuan Veselit se kanë filluar përgatitjet intensive për zgjedhje dhe fitore. "Vizioni ynë, përfundimi i proceseve të shtetndërtimit, vendimet e mëdha në dobi të mirëqenies së qytetarëve, guximi për marrjen e përgjegjësive të reja, janë vetëm disa nga arsyet pse qytetarë anekënd Kosovës po na bashkohen. Kjo fitore e jona do të jetë fitore e Kosovës në Dekadën e Re, për t'i hapë rrugë perspektivës së vendit dhe zhvillimit ekonomik", ka thënë Veseli para anëtarëve të këtyre katër degëve.

Ai ka thënë se ka një optimizëm dhe mobilizim të madh në të gjitha degët. "Me njerëz të mirë, të aftë e të ndershëm, punëtorë e profesionistë të zellshëm që duan të punojnë për vendin e tyre, do të ketë vetëm fitore për Kosovën", ka deklaruar ai.

Veseli ka potencuar se PDK-ja nëpërmjet procesit të brendshëm zgjedhor ka përzgjedhur organet e degëve dhe organet e tjera të partisë, duke u fuqizuar më tutje për sfidat politike me të cilat po përballet vendi. Ai ka ritheksuar se PDK-ja është e gatshme për zgjedhjet e parakohshme parlamentare si dhe do ta ofrojë platformën më të mirë politike për qytetarët. "Ne jemi gati për zgjedhje, ashtu siç është vizioni ynë, i prezantuar në procesin e brendshëm zgjedhor, Dekada e Re, për t'u përgjigjur ndaj sfidave të zhvillimit, procesit integrues dhe të ardhmes së të rinjve tanë këtu", ka theksuar Veseli, duke potencuar se PDK-ja çdoherë është e gatshme t'i shtyjë tutje suksesshëm agjendat zhvillimore të vendit.

# Haradinaj takohet me bashkatdhetarët



PRISHTINË, 29 KORRIK (ER) - "Shqiptarët janë me fat me ju, me fat për diasporën, sepse nuk ka hequr dorë prej atdheut në asnjë rrethanë, në asnjë etapë, edhe kur kishit vështirësi. E vërteta është se ne në Kosovë i kemi disa sfida dhe nuk i kemi kryer të gjitha punët e vendit, por do t'i përmbyllim. Kosova duhet ta përmbyllë shtetësinë e vet, duhet të jetë anëtare e OKB-së, NATO-s, duhet t'u përgjigjet interesave të qytetarëve të vet së pari, e pastaj të jetë mik i mirë për miqtë dhe të mos lejojë të dështojë. Të gjitha këto punë i bëjmë, kuptohet jo aq lehtë, dhe nganjëherë kemi vështirësi dhe sfida që i shihni edhe ju", kështu ka thënë kryeministri në detyrë i Kosovës, Ramush Haradinaj, në pritjen organizuar për bashkatdhetarët tanë që jetojnë në diasporë.

Kryeministri Haradinaj para bashkatdhetarëve kujtoi periudhën kur në moshën 16-vjeçare ka shkuar në diasporë për t'i parë mundësitë, duke qëndruar atje për dhjetë vjet dhe ka theksuar se jetën që e bëjnë bashkatdhetarët e njeh nga perspektiva e një punëtori. "Nuk ka qenë e lehtë, por sfiduese në të gjitha drejtimet. Është sfiduese, sepse atje punohet, fitohet, por edhe standardi është i lartë. Pastaj ne jemi shqiptarë. Kudo që jemi dëshirojmë ta ruajmë veten, identitetin, ta ruajmë fëmijën tonë në tradita, vlera sepse nuk është e lehtë në vend të huaj", është shprehur Haradinaj, duke shtuar se një gjë që nuk ndryshon asnjëherë është dashuria e njerëzve për vendin e vet, për tokën dhe vendin e lindjes.

Riza Sheqiri, shkrimtar nga Suedia, ka falënderuar kryeministrin Haradinaj për pritje, duke thënë se diaspora shqiptare sot krijon vlera të cilat i reflekton te vendlindja.

## Vlerësohet roli i gruas shqiptare për ruajtjen e traditave në diasporë

PRISHTINË, 29 KORRIK (ER) - Ministria e Diasporës dhe Investimeve Strategjike ka organizuar konferencën me temë "Gruaja në diasporë - digë e fuqishme kundër asimilimit". Zëvendësministri i Diasporës dhe Investimeve Strategjike, Isni Kilaj, u shpreh se kjo konferencë i kushtohet rolit të gruas në diasporë dhe rëndësisë që ka ajo në bartjen e kulturës dhe traditës shqiptare në diasporë. "Konferenca po mbahet në kuadër të aktiviteteve që Ministria e Diasporës dhe Investimeve Strategjike është duke organizuar në këta dy muajt e verës. Është një konferencë e cila i kushtohet rolit të gruas shqiptare në diasporë, rëndësisë që ajo ka për bartjen e kulturës dhe trashëgimisë sonë shqiptare", ka thënë Kilaj. Ai ka vlerësuar se diaspora shqiptare në botë, sidomos në Evropë, është ndër më të organizuarat.



# Braktisen fshatrat, mbipopullohen qytetet

Krahas dukurisë së emigrimit të qytetarëve të Kosovës drejt vendeve evropiane, por edhe më gjerë, një dukuri tjetër është edhe migrimi i brendshëm, që kryesisht ka si destinim braktisjen e zonave rurale dhe për një jetë të re në viset urbane

PRISHTINË, 29 KORRIK - Punësimi dhe arsimimi shihen ndër arsyet kryesore pse njerëzit pëlqejnë t'i braktisin fshatrat për të jetuar në qytete. Sipas të dhënave të fundit të Agjencisë së Statistikave të Kosovës, vetëm në vitin e kaluar janë shënuar rreth 9 000 raste të lëvizjeve të brendshme të popullsisë nga një komunë në tjetrën, kryesisht nga viset rurale në ato urbane.

Hajriz Ademi ka 15 vjet që është larguar me familje nga një fshat në rrethinën e Komunës së Prishtinës për t'u vendosur për banim brenda kryeqytetit të Kosovës, në Prishtinë. Ademi, i cili punon në sektorin e arsimit, së bashku me tetë anëtarët e familjes jeton në një banesë në një nga lagjet e Prishtinës. Ai thotë se ka qenë i detyruar për një vendim të tillë pasi, sipas tij, edhe pse infrastruktura rrugore është rregulluar, arsimimi dhe punësimi i fëmijëve në qytete është më i lehtë sesa në viset rurale. "Janë disa rrethana dhe kontradikta krejt ndryshe. Duke pasur parasysh elementin bujqësor i cili ka humbur kuptimin e vet, tani njeriu duhet ta lëshojë vendlindjen dhe të afrohet afër ndonjë qendre për arsye pune apo të mirave materiale, pasi që fshati i ka humbur ato të mira dhe nuk leverdis më për të gjithë", ka deklaruar Ademi.

Shpërnguljet e mëdha të popullatës nga vendet rurale në ato urbane nisën që prej para luftës, kurse vazhduan me ritëm edhe më të lartë pas luftës. Kryeqyteti, Prishtina, dominon si destinacioni më i pëlqyer për migrim. Në faqen zyrtare të Komunës së Prishtinës thuhet se vetëm kjo komunë numëron rreth 200 mijë banorë, nga të cilët 161 mijë jetojnë në zona urbane dhe 37 mijë në zonat rurale. Por, jozyrtarisht, demografët besojnë se në Prishtinë jetojnë numër më i madh i banorëve krahasuar me shifrat zyrtare, pasi një numër i konsiderueshëm jetojnë në Prishtinë me qira dhe nuk janë të regjistruar fare. Kjo zhvendosje, sipas ekspertëve, po ndodh me vetë vullnetin e qytetarëve, në kërkim të një jete më të mirë.

Demografi Rifat Blaku, në një prononcim për "Radion Evropa e Lirë", thotë se qytetarët po braktisin fshatrat për arsye shkollimi dhe punësimi. Ai ka treguar se vetëm infrastruktura rrugore nuk mjafton për një jetë normale në fshat andaj, thekson ai, duhet të gjenden forma nga institucionet qeveritare që të ofrohen zgjidhje për parandalimin e këtij fenomeni. "Është e vërtetë se në shkallë republike në vitet e pasluftës janë bërë investime në infrastrukturë dhe janë ndërtuar disa shkolla dhe maternitete. Por, ato janë simbolike, kështu që gjendja dhe pasqyrimi më i mirë është migrimi, eksodi nga fshati në qytet. Mjerisht problemi është në manifestim dhe nuk është duke u qetësuar", është shprehur Blaku.


Bujar Tërstena (RFE/RL)

Pavarësisht prej shpërnguljes së numrit të madh të qytetarëve nga fshatrat në qytete, Blaku thotë se as viset urbane nuk përmbushin synimet e atyre që vendosin të jetojnë nëpër qytete. "Janë faktorët shtrëngues që i shtynë në masë të madhe, kryesisht të rinjtë, por edhe familje që t'i braktisin fshatrat dhe t'ua mësyjnë qyteteve, me shpresë se atje do të gjejnë një perspektivë, punë, shkollim apo përmirësim të statusit të tyre social. Por, faktorët atraktivë të qyteteve nuk janë ashtu siç është pritur dhe çfarë është shpresuar pas përfundimit të luftës. Sepse kemi të bëjmë me një zhvillim të paqëndrueshëm të kapitalizmit në Kosovë", ka thënë Blaku. Sipas të dhënave të Agjencisë së Statistikave, numri i përgjithshëm i banorëve në Kosovë vitin e kaluar ka qenë rreth 1.8 milion. Nga kjo shifër në vitin 2011, sipas regjistrimit të fundit të popullsisë, rezulton se 61.7 për qind e popullatës jetojnë në zonat rurale, kurse 38.3 për qind në zonat urbane. Në një kilometër katror në Kosovë jetojnë 164 banorë.

# Në QKUK fillon vlerësimi i rrezikshmërisë në punë

EPOKA E RE **Faton DËRMAKU**

PRISHTINË, 29 KORRIK - Sektori për Mbrojtje dhe Siguri në Punë, i cili funksionon në kuadër të ShSKUK-së, ka realizuar për herë të parë vlerësimin e rrezikut në vendet e punës në Shërbimin Klinik të Mjekësisë Nukleare në QKUK, bazuar në nenin 16 të Ligjit Nr. 04/L-161, për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë, aktet e tjera normative në fuqi dhe standardeve ndërkombëtare. Duke marrë për bazë natyrën e punës së këtij shërbimi, fillimisht është bërë vlerësimi i rrezikut në këtë shërbim dhe gradualisht do të përfshihen të gjitha vendet e punës të njësive përbërëse të QKUK-së dhe ShSKUK-së konform standardeve të kërkuara.

Metodat e vlerësimit të rrezikut japin mundësi të identifikohen të gjitha objektet specifike të cilat mund t'i dëmtojnë personat dhe mund të shkaktojnë pasoja të padëshirueshme në punë. Ato japin mundësinë të vlerësohet serioziteti i një ngjarjeje të tillë të mundshme si dhe të identifikohen zgjidhjet më të përshtatshme për mbrojtjen kundër këtyre pasojave.



Qëllimi është që përmes vlerësimit të rrezikut për Shërbimin Klinik të Mjekësisë Nukleare dhe shërbimet e tjera në QKUK-ShSKUK-së, të përcaktohen masat e nevojshme për sigurinë në punë si dhe përgjegjësitë për t'i krijuar kushtet më të sigurta dhe më të shëndetshme në të gjitha aspektet e punës.

Gjatë aktit të vlerësimit të rrezikut është bërë edhe trajnimi i punëtorëve nga moduli për aftësimin e punëtorëve për kryerjen e punëve në mënyrë të sigurt, nga lëmi i sigurisë dhe shëndetit në punë, ku edhe janë certifikuar.

# MTI-ja obligon kompanitë që shesin derivate t'i pastrojnë rezervuarët

Ministri i Tregtisë dhe Industrisë, Endrit Shala, ka nënshkruar udhëzimin administrativ që obligon kompanitë që shesin derivate t'i pastrojnë rezervuarët çdo tre vjet. Ministri Shala ka thënë se kjo po bëhet për herë të parë, me qëllim të mbrojtjes së konsumatorit



EPOKA E RE A. MAVRAJ

PRISHTINË, 29 KORRIK - Ministri i Tregtisë dhe Industrisë, Endrit Shala, ka nënshkruar udhëzimin administrativ që obligon kompanitë që shesin derivate t'i pastrojnë rezervarët çdo tre vjet. Ministri Shala ka thënë se kjo po bëhet për herë të parë, me qëllim të mbrojtjes së konsumatorit. "Për herë të parë do të pastrohen rezervuarët e pompave të derivateve në Republikën e Kosovës me qëllim të mbrojtjes së konsumatorit. Para disa jave kam nënshkruar udhëzimin administrativ me të cilin obligohen kompanitë që tregtojnë derivate në tregun tonë që t'i pastrojnë rezervuarët e derivateve çdo tri vjet", ka thënë ministri Shala.

Ai ka bërë me dije se ka pasur shumë ankesa për cilësi të naftës, por tashmë secila kompani që kërkon të licencohet duhet t'i pastrojë rezervuarët. "Për 20 vjet rresht në Kosovë kemi pasur ankesa për cilësinë e naftës. Jemi sfiduar për kontroll të kualitetit, por asnjëherë deri tani nuk kemi obliguar kompanitë që t'i pastrojnë rezervuarët në të cilët mbajnë këto derivate. Tashmë secila kompani që licencohet për tregti me derivate do ta ketë edhe njërin nga kriteret kyçe pastrimin e rezervuarëve, duke e mbrojtur konsumatorin. Pastrimi do të bëhet në përputhje të plotë me standardet evropiane duke rritur edhe kualitetin në tregun vendor", ka thënë Shala.

Ministri ka theksuar se kontrolli do të vazhdojë me qëllim të rritjes së cilësisë dhe mbrojtjes së konsumatorit. "Qëndroj i palëkundur për kontroll të cilësisë dhe mbrojtje të konsumatorit. Tashmë është ridraftuar edhe ligji i ri për naftën dhe shumë shpejt do të jetë në Kuvend. Aty parashohim edhe hapa të tjerë me qëllim të rritjes së cilësisë, kontrollit të tregut, rritjes së të hyrave për shtetin me synimin e vetëm, mbrojtjen e konsumatorit", ka thënë Shala.

# Punëtorët e Telekomit hyjnë në grevë, kundërshtojnë kontratën e re me 'Z-Mobile'

EPOKA E RE Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 29 KORRIK - Punëtorët e Telekomit të Kosovës në krye me sindikalistin Lahmi Balaj kanë filluar të hënën grevën për parandalimin e lidhjes së kontratës së re me "Z-Mobile". Ata kanë bërë me dije se do të kërkojnë nga gjykatat e vendit që mos të lejojnë ekzekutimin e vendimit të arbitrazhit për përmbarim.

Kryetari i Sindikatës së Punëtorëve të Telekomit të Kosovës, Lahmih Balaj, ka deklaruar se do ta vazhdojnë grevën deri në plotësimin e kërkesës së tyre që është mosvazhdimi i kontratës me "Z-Mobile". "Kërkesat janë ato të njëjtat. Mosvazhdimi i kontratës me 'Z-Mobile', e cila përfundon më 30 korrik, që tashmë është e njohur në opinionin publik se është një kontratë e dëmshme. Kjo kontratë e ka sjellë Telekomin në këtë gjendje. Greva që ka filluar sot do të vazhdojë deri në realizim e kërkesave tona", ka thënë ai.

Grevës të hënën nuk i janë bashkuar të gjithë punëtorët e Telekomit, por Balaj ka thënë se nga dita e martë do t'i bashkohen të gjithë punëtorët në nivel vendi. "Sot ka qenë fillimi i grevës, por nga nesër greva do të jetë e përgjithshme. Nga të gjitha regjionet do të vijnë punëtorët dhe nuk do të ndalemi në greva 24 orë", ka deklaruar ai, duke shtuar se do të jenë përkrah konsumatorëve. "Në asnjë mënyrë ne nuk do të ndalemi dhe nuk do t'i dëmtojmë konsumatorët tanë. Do të jemi përkrah konsumatorëve. Nuk do të lejojmë punëtorët që asnjë shërbim në terren ta realizojnë pa u realizuar kërkesat tona. Pra, të mos vazhdohet kontrata me 'Z-Mobile'", ka thënë Balaj, duke theksuar se nuk u besojnë fjalëve të kryeshefit të Telekomit. "Kur të dilet me një shkresë zyrtare ne jemi të gatshëm për ta ndërprerë grevën. Nëse tentohet që të vazhdohet prapë kontrata me 'Z-Mobile' do të shkojmë në grevë të përgjithshme në gjithë Kosovën", ka thënë Balaj. Sipas tij, përgjegjësit për këtë gjendje në Telekom duhet të dalin para drejtësisë me "klanet e brendshme". "Besoj se shumë shpejt përgjegjësit e 'Z-Mobile' do të dalin para drejtësisë për t'i paguar ato dëme që ia kanë shkaktuar Telekomit të Kosovës bashkë me klanet brenda Telekomit dhe me individët jashtë", ka thënë Balaj.




## Banka Botërore në përgatitje të një projekti të ri në Kosovë që përmirëson furnizimin me ujë

PRISHTINË, 29 KORRIK (ER) - Banka Botërore ka njoftuar se është në përgatitje të një projekti të ri në Kosovë që do ta përmirësojë furnizimin me ujë në zonën e lumit Morava e Binçës në Kosovën lindore, që është zona më e thatë në Kosovë, me më së paku të reshura vjetore. Sipas njoftimit nga Banka Botërore, ky projekt synon që popullsia e kësaj zone të ketë furnizim më të mirë me ujë, përfshirë këtu edhe shërbime të reja apo të përmirësuara për ujitje. "Ngritja e një vend-akumulimi të ri të ujit do të jetë investimi më i madh kryesor në kuadër të projektit të propozuar. Projekti i emëruar Ngritja dhe Shfrytëzimi i Mundësive për Siguri të Ujit (FLOWS) po ashtu synon ta përmirësojë planifikimin dhe koordinimin e menaxhimit të burimeve të ujit në këtë zonë", thuhet në njoftimin e BB-së.



Me rastin e njëvjetorit të vdekjes së Adem Demaçit, 26 korrik 2018 (6)

# ADEM DEMAÇI, HERO I KOSOVËS DHE NDERI I KOMBIT

## - Përshtypjet në "librin e zisë"



**Përgatiti: Selatin Novosella**

Prehu i qetë në dheun tonë për të cilin vuajte aq shumë dhe ne betohemi se do ta qojmë në vend amanetin tënd për ta vendosur kufirin atje në Malin e rrallë me lisa, ku qelin shqiponjat në Gollak, atje ku na i pat pre armiku, nuk i harrojmë kurrë, Bacë!

*27 korrik 2018,*
*Halil Canolli, Sabit Rama*

Faleminderit për gjithçka që bëre për ne dhe fëmijët tanë! Lavdi!

*27 korrik 2018,*
*Vlora Asllani*

Lavdi i qoftë për jetë, shqiptarit të vërtetë, Bacës Adem Demaçi!

*27 korrik 2018,*
*Çamëri (Shaban) Shala*

Diell që nuk perëndon asnjëherë! Lavdi!

*27 korrik 2018,*
*Valbona Shala*

Lavdi për jetë e mot, Bacës Adem!

*27 korrik 2018,*
*Donika Novosella*

Lavdi heroit të kombit shqiptar anë e mbanë botës, kudo që jetojmë ne shqiptarët!

*27 korrik 2018,*
*Vlora Novosella*

Ti ishe frymëzimi më i madh për mua në rrugën tonë çlirimtare! Faleminderit për gjithçka që keni bërë për lirinë dhe bashkimin kombëtar!

*27 korrik 2018,*
*Adnan Asllani*

Bacë, të ma bësh hallall sakrificën për të na nxjerrë nga errësira në dritë lirie. Të qoftë i lehtë dheu për të cilin bëre mund të paparë! Ngushëllime për gjithë kombin shqiptar, për këtë humbje të madhe. Ti, Bacë, Nuk do të jeni fizikisht në mesin tonë për do jetoni me ne përgjithmonë!

*27 korrik 2018,*
*Mejdi Asllani-Plaku*

Respekt për jetën dhe veprën e Bacës Adem Demaçi!

*27 korrik 2018,*
*(emri i palexueshëm) Krasniqi, Zllash*

I pavdekshëm do jesh në mendjet dhe zemrat e të gjithë atyre që duan liri-drejtësi-shqiptari! I përjetshëm kujtimi për ty!

*27 korrik 2018,*
*(emri i palexueshëm) Bajraktari*

Ngushëllime familjeve të Kosovës, të Shqipnisë dhe gjithë shqiptarëve!

*27 korrik 2018,*
*(nënshkrimi i palexueshëm)*

Fjalët janë të pakta që të shprehim dhembjen për Ty Bacë! Ishe ikonë dhe simbol i çdo shqiptari! Pusho i qetë në dheun e Kosovës!

*27 korrik 2018,*
*Xhavit Kabashi, Gëzim Kabashi*

Ah, Bacë, na ike pa i mbushur 111, ashtu siç më premtove, nuk u bë! Por jo, nuk ke ikur, je e do të jesh gjithnjë me ne, me popullin tënd. Gjithnjë në mendjet dhe zemrat tona. Me pikëllim të thellë.

*27 korrik 2018,*
*Ibrahim dhe Emine Xhemajli*

Vdekja Jote, dhembje e krenari, ashtu siç ishte edhe jeta Juaj!

*27 korrik 2018,*
*Shqipe dhe Avdi Xhemajli*

Lamtumirë zemra e madhe e Kombit. Nga sot, qielli i Kosovës do të ketë ngjyrën e flamurit kombëtar, nga sot qielli i Kosovës do të ketë emrin Adem Demaçi! Lavdi!

*27 korrik 2018,*
*Vllaznim Berisha*

Zoti të shpërbleftë për krejt atë çka ke bërë për popullin dhe atdheun tënd!

*27 korrik 2018,*
*Xhemshit (mbiemri i palexueshëm)*

Kur vdes mësuesi, ligështohet kombi! Lavdi jetës veprës së tij!

*27 korrik 2018,*
*Vezir Ukaj*

Ngushëllime familjes nga mbesat e Avdyl Dures, aktivist i Këshilli për të Drejtat dhe Liritë e Njeriut.

*27 korrik 2018,*
*Zelfije Zenuni - Kashtanjeva*

Mbetsh i gjallë në jetë të jetëve, Baca Adem!

*27 korrik 2018,*
*Abdyl G. Buja*

Rron, rron përjetë, Baca Adem Demaçi!

*27 korrik 2018,*
*Xhevat Zekaj*

I pavdekshëm për popullin dhe revolucionarët. Simbol i rezistencës, Adem Demaçi!

*27 korrik 2018,*
*Skënder Berisha*

U prehsh në paqe në dheun e Kosovës, i madhi Baca Adem!

*27 korrik 2018,*
*Z. Saqipi*

Kush tha se ka vdekur Adem Demaçi....!!!... Ai jeton përherë!

*27 korrik 2018,*
*Mustafë H. Lajçi*

O Baca Adem, i madh ke qenë dhe vepra juaj e madhe do mbetet!

*27 korrik 2018,*
*R. Mexhani*

Humbje e madhe për gjithë kombin shqiptar! Ishe e do mbetesh përherë me ne për të na bërë dritë gjithmonë!

*27 korrik 2018,*
*E. Ahmeti*

Humbje për të gjithë ne, veçanërisht për ata që ishin të pajisur me idealet kombëtare. Ideali i Tij shërbeu si frymëzim për të gjithë ata që i kontribuan lirisë dhe zhvillimit të vendit!

*27 korrik 2018,*
*Berat Rukiqi, OEK*

Adem Demaçi ishte dhe mbeti simbol i rezistencës, luftës dhe paqes! Lavdi!

*27 korrik 2018,*
*H. Kaltrina*

Faleminderit që të patëm. Na dhurove jetën drejtë lirisë. Respekt!

*27 korrik 2018,*
*Suad Berisha*

Lavdi jetës dhe veprës së pavdekshme të BACËS ADEM!

*27 korrik 2018,*
*Xhemajl Berisha*

Një jetë e tërë Lavdi! Jetove me lavdi duke lënë edhe vepër të lavdishme!

*27 korrik 2018,*
*Rrahman Hyseni, Medvegjë*

Baca Adem, ishe udhërrëfyes i yni në rrugën tonë të vështirë drejtë lirisë! Respekt!

*27 korrik 2018,*
*Rexhep Halimi*

Në emër të Drejtoratit të Përgjithshëm të Policisë, z. Naim Rexha dhe menaxhmentit policor, shprehu ngushëllimet më të veçanta për Emblemën Shqiptare,



Adem Demaçin! Zoti e shpërbleftë!

*27 korrik 2018,*
*Major, Muhamet Berisha*

Në emër të familjes Fazliu, shprehu ngushëllimet më të sinqerta për Bacën! I qoftë i lehtë dheu i Kosovës!

*27 korrik 2018,*
*(emri i palexueshëm)*

Nderime për të madhin Adem Demaçi! Ishte dhe mbeti figurë e ndritshme e kombit shqiptar!

*27 korrik 2018,*
*(nënshkrimi i palexueshëm)*

Nderime për Bacën Adem, heroin e nacionalistin më të madh për të drejtat e popullit shqiptar! Lavdi jetës dhe veprës së tij!

*27 korrik 2018,*
*Hazir Kadir Deralla*

I përjetshëm të mbetet kujtimi për njeriun e madh që ndryshoi historinë me shkrimet dhe me qëndresën e paluhatshme kundër pushtuesit serbo-sllav. Lavdi Mendeles së Kosovës, Bacës Adem Demaçi! LAVDI!

*27 korrik 2018,*
*Adem Ismajl Muriqi*

U prehsh në paqe!

*27 korrik 2018,*
*(nënshkrimi i palexueshëm)*

Baca Adem, shkove në përjetësi të kombit shqiptar të cilin e deshe dhe të deshi aq shumë! Zoti i Madhërishëm të nderoftë me të gjitha begatitë e tij, ashtu siç e nderove Ti, në çdo moment të jetës tënde kombin tënd të dashur!

*27 korrik 2018,*
*Dr. Ferid Agani, kryetari i Partisë së Drejtësisë*

Shoku i gjeneratës, na le, por do të jesh për jetë në zemrat tona dhe të mbarë popullit shqiptar! Lavdi të qoftë përherë!

*27 korrik 2018,*
*(nënshkrimi i palexueshëm)*

Krenohemi të gjithë ndërgjegjja kombëtare, që na priu Baca në rrugën e lirisë. Lavdi për jetë e mot veprës Tënde!

*27 korrik 2018,*
*(nënshkrimi i palexueshëm)*

Sakrifica dhe vetëflijimi për interesin kombëtar ka vetëm një emër - Baca ADEM DEMAÇI!

*27 korrik 2018,*
*Afrim Fusha*

Baca Adem, fizikisht jeni ndarë nga ne, por përjetësisht do jetoni me ne vepra juaj, si hero i cili asnjëherë nuk u ndal luftës për çështjen dhe lirinë kombëtare. Ju qoftë i lehtë dheu i Kosovës!

*27 korrik 2018,*
*(nënshkrimi i palexueshëm)*

Lavdi për jetën dhe veprën Tuaj!

*27 korrik 2018,*
*(nënshkrimi i palexueshëm)*

O i madhi, Baca, Adem Demaçi! Lum Kosova, lum Shqipëria, që të kanë pasë!

*27 korrik 2018,*
*(nënshkrimi i palexueshëm)*

Si të jetojmë pa ty dhe patriotizmin tënd, Baca Adem... LAVDI!

*27 korrik 2018,*
*R. Thaçi*

**(Vazhdon në numrin e ardhshëm)**

Fizika simetrike, udhëtim drejt universit (13)

# NEUTRONI



Shkruan: Naim KRASNIQI, fizikan

Neutroni është një grimcë elementare pa ngarkesë elektrike.
Përbëhet nga tri kuarte: një kuart pozitiv (2/3 u) dhe dy kuarte negative (-1/3 d).
Ka disa arsye se pse kjo grimcë mbetet e pa ngarkuar:
- Për dallim nga protoni dhe elektroni, te neutroni mungon fenomeni i tornados, i cili do të bënte përzierjen e kuarteve;
- Fenomeni i tornados rrotullohet në të njëjtën kahe dhe drejtim me vetë neutronin si dhe mund të jetë;
- Sasia e barabartë e kuarteve e bën të pamundshme ngarkimin e neutronit.

*Përfundim*

Sikur të ekzistonte një forcë nga jashtë që do ta eliminonte në mënyrë automatike fushën magnetike të diellit, nuk do të ekzistonte fusha antimagnetike e diellit si forcë antigravitacionale, dhe për një kohë të shkurtër të gjithë trupat qiellorë do të përfundonin në brendësi të diellit.
Sikur të mos ekzistonte një antifushë elektrostatike që buron sikur nga elektronet ashtu edhe nga protonet, nuk do të ekzistonte asnjë atom.

*Rrezikshmëria*

Pasi në mes protoneve dhe elektroneve ndryshon vetëm ngarkesa elektrike dh asgjë më shumë, prandaj mund të themi strukturat e brendshme të protoneve dhe elektroneve janë identike.
Në këtë mënyrë të kryhen teste me elektrone të ndryshme të elementeve të rënda nëpër laboratorë ngjashëm sikur është laboratori CERN që ndodhet në mes Zvicrës dhe Francës është po aq rrezikshme sa të kryhen teste me protone të apo të njëjtit element, kjo mund të sjellë efekte negative të pa imagjinueshme, madje edhe krijimin e vrimave të zeza.

*Drita dhe shpejtësia e saj*

Në univers asgjë nuk lëviz pa veprimin e një force të jashtme. Kurse për dritën themi se ajo lëviz rreth 300 000 Km/sec. Shkenca e ka nxjerrë në formë eksperimentale këtë shpejtësi në tokë, por asnjëherë kjo shpejtësi nuk është matur jashtë tokës qoftë në një planet tjetër. Dihet se drita shpërndahet në formë të valëve elektromagnetike, por fatkeqësisht shkenca asnjëherë nuk e ka ditë shkakun e vërtetë se cila forcë e shpërndan dritën.
Nëse valët nuk vihen në lëvizje nga një forcë e jashtme, as drita nuk lëvizë. Po të ishte ashtu se drita lëviz edhe pa veprimin e një force të jashtme, do të mjaftonte që një yll do ta ndriçonte tërë universin, dhe s'do të ekzistonte errësirë në asnjërën anë të trupave qiellorë, por as nata në tokë. Prandaj ky është një argument se drita shpërndahet nën veprimin e një force të jashtme, që ka intensitet, drejtim dhe kahje të veprimit.
Duke u bazuar në eksperimentet e mëparshme dhe paraqitjen nga ana e ime të fushës antimagnetike si një forcë e re dhe e pa njohur për shkencën që vepron në tërë universin, mund të themi se kjo forcë e fushës antimagnetike konsiderohet si çelësi i vetëm i zgjidhjes së problemeve kryesore në univers.
Prandaj përpos efekteve të lartë përmendura që kanë një lidhshmëri të drejtpërdrejtë me efektet që ndodhin në natyrë dhe në përgjithësi në univers, ngjashëm edhe këtu themi se fusha antimagnetike që buron nga trupat qiellorë sikur është dielli është forca e vetme që e shpërndan dritën nga burimi, çka do të thotë se fusha antimagnetike është shpërndarësi kryesorë i dritës.
Mirëpo problemi lind në mes dritës dhe errësirës, prandaj nëse drita shpërndahet në formë të valëve, atëherë ku qëndron dhe si shpërndahet errësira.
Shembull
Në një dhomë të mbyllur të errët ku nuk mund të depërton drita nga jashtë, e ndezim një llambë drita do të shpërndahet nën veprimin e fushës antimagnetike të tokës duke mos përjashtuar edhe fusha të tjera antimagnetike. Por në momentin si e ndërpremë dritën dhoma errësohet, sepse fusha antimagnetike e shpërndan errësirën duke e mbushur dhomën, sikur mos të shpërndahej errësira drita do të qëndronte edhe një kohë të gjatë, parandej sikur drita ashtu edhe errësira shpërndahen nga fushat antimagnetike të trupave qiellorë.
Sikur mos të ishte shpërndarë errësira ngjashëm sikur drita ne do shihnim edhe një qiri të ndezur në planetin e Plutonit, por as nata nuk do të ekzistonte në anën e kundërt të tokës ku nuk bien rrezet e diellit, sepse fusha antimagnetike e tokës e mbron errësirën, që në një formë e shpërndan errësirën.
Pasi intensiteti i fushës antimagnetike nuk është një madhësi konstante te trupat qiellorë,por varet nga shumë faktorë, ashtu edhe shpejtësia e dritës nuk ka vlerë konstante por varet nga intensiteti i fushës antimagnetike të atij trupi qiellorë prej nga buron. Kështu që me ndryshimin e intensitetit të fushës antimagnetike ndryshon edhe shpejtësia e dritës.
Intensiteti i fushës antimagnetike është tejet i lartë afër diellit në krahasim me tokën, prandaj edhe shpejtësia e dritës është shumë here ma e lartë afër diellit se sa në sipërfaqen e tokës.
Fusha antimagnetike e diellit e shpërndan dritën në drejtim të tokës, dhe mendohet se kësaj drite i duhen 8 minuta e 20 sekonda për të arritur në tokë. kjo nuk është e vërtetë. Shpejtësia e dritës në tokë mund ta ketë vlerën e 300 000 km në një rreze që nuk kalon disa qindra kilometra nga sipërfaqja e tokës, sepse kjo është një zonë ku konfrontohen fusha antimagnetike e diellit dhe fusha antimagnetike e tokës duke mos përjashtuar edhe fusha antimagnetike të trupave të tjerë qiellorë.
Le ta marrim një shembull një aeroplan që lëviz me të njëjtën forcë të motorëve me shpejtësi konstante. Sado piloti tenton ta mbajë këtë shpejtësi konstante ajo nuk është e mundshme për shkak të turbulencave që hasë gjatë udhëtimit. Prandaj këto turbulenca varësisht intensitetit të tyre e ngadalësojnë shpejtësinë e aeroplanit.
Tërësisht ngjashëm edhe drita buron nga dielli me një shpejtësi konstante, por kjo shpejtësi konstante mund të jetë vetëm në fillim, por duke u larguar nga dielli zvogëlohet edhe shpejtësia e dritës, për shkak se fusha antimagnetike e diellit si bartëse e dritës takohet në fusha antimagnetike të trupave të tjerë qiellorë duke e përfshi edhe tokën.
Në këtë rast shpejtësia e saj zvogëlohet ashtu sikur zvogëlohet intensiteti i fushës antimagnetike të diellit, kurse këtë zvogëlim të shpejtësisë e ndihmon edhe fusha antimagnetike e tokës, e cila e kundërshton fushën antimagnetike të diellit.
Prandaj drita vetëm rreth disa qindra kilometrat e fundit i kalon me shpejtësi 300 000 Km /sec sepse shpejtësia e saj zvogëlohet sa ma larg diellit.
Meqenëse i tërë universi është i mbushur me trupa qiellorë nga të cilët burojnë fusha antimagnetike qoftë yje apo planetë atëherë edhe drita shpërndahet në ç'do skaj të universit duke përfshi edhe trupa qiellorë të cilët nuk posedojnë fushë antimagnetike, kurse shpejtësia e dritës është proporcionale me intensitetin e fushës antimagnetike.

*Argument 1*

Na ka ndodhur shumë herë që Hënën ta shohim me një rreth të ndritshëm që e rrethon, kjo ndodhë për arsye se Hëna ndodhet në mes të dy apo më shumë trupave qiellorë që posedojnë fusha antimagnetike.
Si shembull konkret po e marrim këtë fotografi që është bëre më 13/06/ 2019 në trekëndëshin Francë-Zvicër-Gjermani në orën 22:15 minuta (shih figurën 52). **Vijon.**




Fig. 52

## Johnson: Të gatshëm të diskutojmë për Brexitin kur BE-ja ta ndryshojë qëndrimin

**Londër, 29 korrik** - Kryeministri i Britanisë së Madhe, Boris Johnson, u tha udhëheqësve të Bashkimit Evropian se ai do të bisedojë me ta për Brexitin, apo daljen e Britanisë nga BE-ja, kur ata t'i ndryshojnë qëndrimet për marrëveshjen e divorcit.
Në të kundërtën, Britania do të përgatitet të dalë nga blloku pa marrëveshje, tha zëdhënësja e Johnsonit.
Qëkur është bërë kryeministër javën e kaluar, Johnsoni ka biseduar me disa udhëheqës të BE-së, por ai nuk ka deklaruar ende se kur do ta bëjë vizitën e parë jashtë vendit. "Kryeministri ua ka bërë të qartë qëndrimin udhëheqësve evropianë. Marrëveshja e tërheqjes nuk ka mundur të kalojë në Parlament tri herë, andaj duhet të ndryshojë", u tha zëdhënësja e Johnsonit gazetarëve në Londër. "Kryeministri do të jetë i lumtur të bisedojë kur pozicionet të ndryshojnë", tha ajo.
Britania ka arritur marrëveshje me BE-në mbi kushtet e divorcit nëntorin e kaluar, pas dy vjetësh negociata. Por, ajo është refuzuar tri herë nga Parlamenti britanik, çfarë ka çuar edhe në dorëheqjen e kryeministres së deritashme britanike, Theresa May.



# Diplomacia dhe Pheniani në qendër të takimit të vendeve të ASEAN

**Në gusht ministrat e jashtëm të Shoqatës së Vendeve të Azisë Juglindore (ASEAN) pritet të takohen në Bangkok, për një forum rajonal, ku krahas çështjeve diplomatike pritet të diskutohet edhe rreth programit bërthamor të Koresë së Veriut**

**Bangkok, 29 korrik** - Ministrat e jashtëm të Shoqatës së Vendeve të Azisë Juglindore (ASEAN) do të takohen në Bangkok më 2 gusht, për një forum rajonal. Krahas çështjeve diplomatike aty pritet të diskutohet edhe rreth programit bërthamor të Koresë së Veriut. Ndërkohë fati i bisedimeve bërthamore mes Uashingtonit dhe Phenianit mbetet i paqartë, në kushtet kur Pheniani këmbëngul për lehtësim të sanksioneve përpara çarmatimit të plotë e të verifikueshëm bërthamor.
Koreja e Veriut iu bashkua Traktatit të Mospërhapjes së Armëve Bërthamore në vitin 1985, por për vite të tëra nuk pranoi monitorim nga Agjencia Ndërkombëtare e Energjisë Atomike ndërsa i kërkonte forcave amerikane të tërhiqeshin nga Koreja e Jugut.
Në fund të vitit 2002, Pheniani i largoi inspektorët e Agjencisë Ndërkombëtare të Energjisë Atomike (IAEA) dhe njoftoi se në uzinën e tij bërthamore do të riniste puna pasi Organizata e Gadishullit Korean për Zhvillim Energjitik (KEDO) pezulloi furnizimet me naftë, që ishte pjesë e kornizës për të cilin ishte rënë dakord më 1994-n. Në janar të vitit 2003, Koreja e Veriut u largua nga traktati bërthamor i Mospërhapjes së Armëve Bërthamore (NPT).
"Qeveria jonë deklaron se tërheqja nga Traktati, i cili ishte pezulluar në mënyrë të njëanshme dhe të përkohshme, do të hyjë në fuqi automatikisht dhe menjëherë", njoftoi transmetuesi i Koresë së Veriut, KRT.
Por pas këtij momenti në Pekin në gusht të vitit 2003, filluan bisedimet mes dy Koreve, Shteteve të Bashkuara, Japonisë, Rusisë dhe Kinës, për shkak të shqetësimeve se Veriu po rriste rezervat me armë me plutonium.
Në përfundim të katër raundeve të bisedimeve në shtator 2005, të 6 vendet ranë dakord për një marrëveshje kuadër sipas së cilës Pheniani do të hiqte dorë nga programi i tij bërthamor në këmbim të një ndihme të madhe ekonomike dhe furnizim me energji elektrike si dhe di t'i jepej fund izolimit të tij diplomatik.
Një vit më vonë në tetor 2006 Koreja e Veriut kryen një provë me një pajisje bërthamore, ç'ka nxiti vendosjen e sanksioneve të Këshillit të Sigurimit të OKB-së.
Prej këtij momenti Koreja e Veriut kryen 6 prova me armë bërthamore më e fundit në vitin 2017.
Në prill të 2018, Kim Jong Un dhe presidenti i Koresë së Jugut Moon Jae-in premtuan të punojnë për "çarmatimin e plotë të gadishullit Korean", në takimin e parë ndër-korean pas më shumë se një dekadë.
Më 24 maj 2018 Koreja e Veriut njoftoi se kishte çmontuar tërësisht objektin e saj të provave bërthamore Punggye. Të 6 provat bërthamore të Koresë së Veriut janë kryer aty, në tunelet e gërmuara nën malin Mantap në verilindje të vendit.
Aktualisht bisedimet bërthamore mes ShBA-së dhe Phenianit kanë ngecur. Më dy gusht ministrat e jashtëm të Shoqatës së Vendeve të Azisë Juglindore (ASEAN) pritet të takohen në Bangkok, për një forum rajonal. Krahas çështjeve diplomatike pritet të diskutohet edhe rreth programit bërthamor të Koresë së Veriut.
Mbajtja e këtij forumi vjen ndërsa më 23 korrik 2019-s, agjencia shtetërore e lajmeve e Phenianit njoftoi se Kim Jong Un inspektoi një nëndetëse të madhe të ndërtuar rishtazi, duke sinjalizuar çuarjen më tej të një programi raketash balistike (SLBM) që lëshohen prej nëndetëseve.
Njoftimi vjen ndërsa ka sërish vonesa në rifillimin e bisedimeve mes Koresë së Veriut dhe Shteteve të Bashkuara. Uashingtoni vazhdon të kërkojë që Koreja e Veriut të heqë dorë nga programet e saj të armëve bërthamore e të raketave.




## Pompeo mund të garojë për president në të ardhmen

**Uashington, 29 korrik** - Shefi i diplomacisë amerikane, Mike Pompeo, i konsideruar si një aleat besnik i Donald Trumpit, të hënën nuk e përjashtoi mundësinë për të kandiduar një ditë për president të ShBA-së. "Asnjëherë nuk kam qenë në gjendje të parashikoj se cila do të jetë detyra ime e radhës dhe mendoj se vlen edhe për këtë rast", tha ai si përgjigje ndaj një pyetje mbi ambiciet e tij presidenciale gjatë Klubit Ekonomik të Uashingtonit. "Por nëse mendoj se mund t'i shërbej, nuk ka asgjë që nuk do të bëj për Amerikën", shtoi ai.
Duke përmendur 18 vjet shërbim federal mes ushtrisë, Kongresit dhe tashmë ekzekutivit, ku ka qenë drejtor i CIA-s në fillim të mandatit të Donald Trumpit para se të emërohej sekretar i Shtetit, ai u shpreh se ndien një detyrë kundrejt ShBA-së.




Shijo
Pranverën
me...
Jaffa Champion PLUS
A+C+E
Multifrutti
Taste of World Wide Brand!
2L
Jaffa Champion


AUTOSHKOLLA
“RITMO – L”
Auto Shkolla
“RITMO - L”
Prishtinë
Eksperienca jonë
- përfitimi i juaj.
Ju mirëpret:
Stafi i Auto Shkollës " Ritmo -L "
Tel / kontakt:
044 248 173
044 200 604
044 375 333

E rrallë

# Shkëmbi bie në fushën e orizit



Një shkëmb i madh ka rënë në një fushë orizi në një fshat në lindje të Indisë. Shkëmbi, i cili ra në fshatin Mahadeva në Bihar, peshonte rreth 13 kilogramë dhe kishte copëza magnetike, ka njoftuar në një deklaratë zyra e kryeministrit të shtetit. Imazhet e publikuara në mediat sociale tregojnë fshatarët që qëndrojnë rreth një krateri të madh me baltë që besohet të jetë shkaktuar nga shkëmbi. Shkëmbi është aktualisht i ekspozuar në Muzeun Bihar, por do të transferohet në Qendrën Shkencore Srikrishna, për të bërë një analizë që do të konfirmojë nëse është meteor.


Nitish Kumar
@NitishKumar
Follow
पटना स्थित 1 अणे मार्ग के 'संकल्प' में मधुबनी के लौकही अंचल के ग्राम महादेवा में मिले संभावित उल्का पिण्ड का अवलोकन करते हुए।
tinyurl.com/yxtdbzlt

FOTO E DITES




Një pamje ajrore paraqet një tren pasagjerësh të bllokuar në një zonë të përmbytur në Indi. /Reuters/

E jashtëzakonshme

# Doktorët i zbulojnë në stomak 1.6 kilogram bizhuteri



Doktorët kanë ngelur pa fjalë kur kanë hequr nga stomaku i një vajze 26-vjeçare plot 1.6 kilogram bizhuteri. Runi Khatun ishte paraqitur në spital në West Bengal, Indi pasi filloi të kishte të vjella pas çdo vakti ushqimor. Gjatë operacionit doktorët i hoqën nga stomaku: 69 varëse, 80 vathë, 46 monedha hekuri, 11 pirsing, 4 çelësa, një orë dhe 5 byzylykë. Nëna e vajzës tha se kishte vënë re që në shtëpinë e saj po zhdukeshin bizhuteritë, por nuk ia kishte marrë mendja që vajza e tyre i gëlltiste.

## BARSOLETA E DITËS



**Papagalli:**
**- Erdha ta kthej papagallin që bleva?**
**- Pse?**
**- Sepse është femër.**
**- E çfarë problemi ka që është femër?**
**- Në vend se t'i përsërisë fjalët që i them, i kundërshton të gjitha.**

KINO ABC PRISHTINE

## Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC

**Nga dita e diele ne ora 14:00 dhe 18:00**

## "Spider-Man Far From Home" 3D,

Aksion/Aventurë/Komedi; 2 orë 09 min

Rolet: Tom Holland, Samuel L. Jackson, Zendaya, Cobie Smulders, Jon Favreau, JB Smoove, Jacob Batalon, Martin Starr, Marisa Tomei, Jake Gyllenhaal

Regjia: Jon Watts







**Nga dita e diele ne ora 22:00**

## "STUBER"

Aksion/Komedi; 1 orë 33 min

**Rolet:** Kumail Nanjiani, Dave Bautista, Iko Uwais, Natalie Morales, Betty Gilpin, Jimmy Tatro, with Mira Sorvino, and Karen Gillan

**Regjia:** Michael Dowse

**Në ora 20:00**

## "THE LION KING" 3D

Aventurë/Dramë; 1 orë 58 min

**Rolet:** Donald Glover,Seth Rogen, Chiwetel Ejiofor, Beyonce Knowles-Carter, James Earl Jones, Alfre Woodard, John Oliver

**Regjia:** Jon Favreau







**Nga dt. 08.08.2019**

## "THE ANGRY BIRDS MOVIE 2"

Horror/Triller; 1 ore 39 min

**Rolet:** Jason Sudeikis, Josh Gad, Leslie Jones, Bill Hader, Rachel Bloom, Danny McBride, Peter Dinklage, Nicki Minaj

**Regjia:** Thurop Van Orman

**Për informata dhe rezervime të biletave thirrni FALAS: 0800 22 222 dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, fb: Kino ABC.**



**DASHI**
Mundësitë më të mëdha sot do t'ju jepen në ato ambiente që as nuk e prisnit që do t'ju dëgjohej fjala. Kjo gjë do t'ju habisë pak.



**DEMI**
Keni fituar siguri nga përvoja juaj dhe ky vetëbesim do t'ju bëjë të merrni vendime që në sy të parë mund të duken të rrezikshme.



**BINJAKËT**
Idetë tuaja nuk janë dhe aq të qarta sa duken. Lidhur me një projekt të rëndësishëm është mirë të konsultoheni kur nuk jeni të bindur.



**GAFORRJA**
Edhe pse çdo gjë është kundër jush sot do të dini të reagoni dhe të mos përfshiheni nga pesimizmi. Jeni tipa solarë dhe do t'ia dilni.



**LUANI**
Sot jeni mjaft aktiv në sektorin e punës dhe duket se keni lënë pas dore të gjitha fushat e tjera. Ktheni kokën për një moment edhe nga fusha e ndjenjave.



**VIRGJËRESHA**
Jeni të pavendosur me çdo gjë që do të bëni sot, por me miq të mirë nuk ndiheni asnjëherë vetëm. Do të kërkoni këshilla pa fund.



**PESHORJA**
Dita do të nisë me mjaft debate dhe sqarime brenda mureve të shtëpisë suaj. Do të vendosni t'i diskutoni gjërat hapur.



**AKREPI**
Keni në mend ndryshime të pritshme sa i përket sektorit të punës. Duhet të merrni një lajm përpara se të vendosni çfarë do të bëni.



**SHIGJETARI**
Gabimet që keni bërë në të shkuarën nuk mund t'i fshini me një të rënë të lapsit. Megjithatë, sot do të keni takime interesante në jetën tuaj.



**BRICJAPI**
Një gabim që keni bërë pa dashur po ju turbullon shumë sot. Nuk keni marrë asnjë masë për ta zgjidhur dhe kjo gjë nuk ju lë të qetë.



**UJORI**
Ju jeni padronët e fatit tuaj dhe me këtë bindje sot do të ecni përpara edhe në ato situata që nuk janë në favorin tuaj.



**PESHQIT**
Mos mendoni se mund të arrini gjithçka thjesht dhe pa u lënduar ju ose personat e afërt që doni më shumë.

# Emilia Clarke ribashkohet me Jason Momoa



Emilia Clarke dhe Jason Momoa janë bërë sërish bashkë. Aktorja 32-vjeçare në "Instagram" ka postuar një fotografi me yllin e "Game of Thrones", para ditëlindjes së 40. "Me ty ndihem shumë e vogël. Gëzuar ditëlindjen!", ka shkruar Emilia nën fotografi. Jason Momoa mbush 40 vjet më 1 gusht që i bie e enjte.

# Justin Bieberi i do vëllezërit Jonas






Justin Bieberi ka treguar hapur mbështetjen e tij për vëllezërit Jonas. Këngëtari 25-vjeçar kishte të veshur një bluzë me një fotografi të Nick, Joe dhe Kevin Jonas, derisa doli në West Hollywood, Kaliforni. Justin ishte me gruan e tij Hailey. Kthehemi në mars, kur Justin ndau një video të Hailey duke pranuar se ajo ishte një fans e madhe e vëllezërve Jonas, kur ajo ishte duke u rritur.



# Jasmine Sanders tregon pse e thërrasin Golden Barbie

Jasmine Sanders ka treguar pse të gjithë e thërrasin Golden Barbie. Gjatë intervistës për revistën "legend's Identity", modeluesja 28-vjeçare ka thënë se gjithçka nisi në shkollë. "Një prej mësuesve të mi në shkollë të mesme më thërriste Goldilock, pastaj disa nga miqtë e mi më thoshin 'ti dukesh si një kukull barbie'. Më pas unë dhe motra ime bashkuam Golden me Barbie dhe u bë Golden Barbie", ka treguar ajo. Sandersi ka treguar se ka blerë një shtëpi të re. "Ishte hapi më i madh dhe ndjenja më e fuqishme sepse tani jam në gjendje të them se jam rritur", është shprehur Jasmine Sanders.

# Martohet Leona Lewis



Leona Lewis është martuar me të dashurin e saj Denis Jauch. Këngëtarja 34-vjeçare dhe koreografi 30-vjeçar, u kurorëzuan të shtunën që lamë pas gjatë një ceremonie romantike në Itali. Gjatë dasmës Leona ndërroi tri fustane, një për ceremoni, një për pritjen dhe një për festën më pas, sipas "Hello"-s. Në këtë dasmë morën pjesë 180 persona. "Ne jemi shumë të gatshëm. Dennisi është personi më i sjellshëm që kam takuar ndonjëherë", pati thënë Leona në një intervistë kohë më parë për "Hello".

# DEMONSTRATAT QË E TROND




Mr. Sheremet KRASNIQI

Para një kohe dolën nga shtypi dy vëllimet e librit të konferencës shkencore ndërkombëtare "Demonstratat e vitit 1968" të mbajtur me rastin e 40-vjetorit, më 24-25. XI. 2008. Botues: Shoqata e të Burgosurve Politikë e Kosovës, Instituti i Historisë, Prishtinë dhe Instituti Albanologjik i Prishtinës.

Përurimi i këtyre dy vëllimeve u bë më 24 nëntor 2018 në sallën e madhe të Institutit Albanologjik, në praninë e një numri të madh qytetarësh dhe pjesëmarrës aktivë të këtyre demonstratave, historianë të njohur, si dhe të shumë personaliteteve publike e shoqërore, siç ishin gjenerali Kudusi Lame, Jakup Krasniqi, kryetar i Nismës e të tjerë.

Për vëllimin I "Demonstratat e vitit 1968" folën Avni Dehari, veprimtar i njohur i çështjes kombëtare dhe pjesëmarrës aktiv i këtyre demonstratave, si dhe i burgosuri politik Binak Ulaj, kurse për vëllimin II "Demonstratat e vitit 1968" folën prof. dr. Rifat Blaku dhe mr. Sheremet Krasniqi, edhe ky i fundit pjesëmarrës aktiv i Demonstratave të '68-s. Me këtë rast, për lexuesit po japim fjalën integrale të autorit të këtij shkrimi, me disa përditësime të vogla:

*Të nderuar të pranishëm,*

Ju përshëndes të gjithëve, në mënyrë të veçantë përshëndes brezin tim të Demonstratave të '68-s.

Unë, me këtë rast, do të flas, gati në mënyrë telegrafike, për vëllimin II "Demonstratat e vitit 1968", në cilësinë e lektorit e të sekretarit të redaksisë. Unë kam pasur fatin t'i lekturoj të gjitha kumtesat e demonstratave të vitit 1968 dhe të demonstratave të vitit 1981, me përjashtim të atyre kumtesave që nuk kanë arritur në redaksi dhe që nuk janë përgatitur dhe dërguar me kohë. Gjatë lekturës kam bërë përpjekje që çdo fjalë apo fjali në këto kumtesa të frymojë sa më shqip, por ka pasur edhe të atilla, në të cilat kemi hequr, siç thuhet, të zitë e ullirit për t'i prurë në vete. Për shkak të kohës së kufizuar, nuk do të hyj në ndonjë analizë të thellë të këtij vëllimi, si dhe nuk mund të flas për krejt kumtesat, por e them me përgjegjësi që secila kumtesë sjell diçka të re dhe interesante nga këto demonstrata. Të gjitha këto kumtesa janë të shoqëruara me shkurtore (abstrakt) dhe me rezyme në gjuhën angleze, si dhe me një akribi të lartë shkencore.

Vëllimit II të librit i prin kumtesa e historianit Izber Hoti kushtuar veprimtarit të njohur Ismajl Dumoshi titulluar "Ismajl Dumoshi-trupi dhe shpirti i demonstratave të vitit 1968", në të cilën autori, ndër të tjera, thekson se Ismajl Dumoshi ishte njëri ndër ideatorët dhe udhëheqësit e Demonstratave të vitit 1968 në Prishtinë e më gjerë. Pason kumtesa e Izet Baraliut "Rrethanat që u paraprinë demonstratave shqiptare në rrethin e Therandës më 1968", në të cilën autori, ndër të tjera, thotë se UDB-ja kishte ushtruar dhunë sidomos mbi popullin shqiptar dhe qëllim të vetëm kishte: zhdukjen e qenies shqiptare.

Veprimtari i njohur i kauzës shqiptare, Kadri Rexha, në kumtesën e tij "Vitet e qëndresës të popullit shqiptar", ndër të tjera, thotë se qëndresa e popullit shqiptar ndaj dhunës kolonialiste të Beogradit në vitet gjashtëdhjetë po hynte në një etapë të re të stoicizmit dhe po e hapte në perspektivë një luftë të re...

Prof. dr. Murat Blaku, në kumtesën e tij "Universiteti i Prishtinës dhe demonstratat e vitit 1968", ndër të tjera, shkruan: Sado që mësimi në këtë universitet zhvillohej në të dy gjuhët-serbisht e shqip - ai po hidhte shtat dhe shpejt u shndërrua në një qendër, që po mblidhte studentë nga të gjitha trojet shqiptare të këndej kufirit. Aty, nga kuadrot universitare, bërthamën e të cilëve e përbënin Fehmi Agani, Ali Hadri, Gazmend Zajmi e të tjerë, u shtruan në mënyrë të prerë, të argumentuar e pa ekuivokë, kërkesat mbarëpopullore për korrigjimin e të gjitha padrejtësive që u ishin bërë shqiptarëve pas Luftës së Dytë Botërore.

Ndërkaq Lukë Gjokaj, në kumtesën e tij "Demonstratat shqiptare të vitit 1968 dhe jehona e tyre në Malësi", ndër të tjera, thotë se në demonstratat e vitit 1968 dhanë kontribut të çmuar edhe studentët dhe nxënësit e Malësisë me qendër në Tuz, që shkolloheshin asokohe në Kosovë.

Historiani, dr. Lush Culaj, në kumtesën e tij "1968-ta - viti i revoltës në Evropë", ndër të tjera, thotë se në periudhën e viteve 1967-1968, një valë revoltash preku shumë vende të Evropës, si: Italinë, Spanjën, Britaninë, Francën, Gjermaninë, Çekosllovakinë etj. Lëvizjet në vendet perëndimore kishin kryesisht programe majtiste, kurse në vendet lindore programe më demokratike, ku pretendohej lirimi nga sistemet ngulfatëse socialiste. Në këtë rast, Kosova dhe çështja e pazgjidhur kombëtare e shqiptarëve në Jugosllavi ishin një rast sui generis në krahasim me vendet e tjera. Shqiptarët kërkonin të trajtoheshin të barabartë me kombet e tjera. Veprimtari Nail Draga, nga Mali i Zi, në kumtesën e tij "Ndikimi i demonstratave të vitit 1968 në procesin arsimor te shqiptarët në Mal të Zi", ndër të tjera, shkruan se, ashtu sikurse në viset e tjera shqiptare në ish-Jugosllavi, Demonstratat e vitit 1968 në Kosovë patën efekte pozitive edhe në viset shqiptare në Mal të Zi, sidomos në fushën e arsimit. Kështu, pas këtij viti, pothuajse në të gjitha vendbanimet shqiptare filluan të hapeshin shkollat me mësim në gjuhën shqipe. Nga kjo kohë filluan të përdoreshin edhe tekstet shkollore të botuara në Prishtinë, si dhe përdorimi i gjuhës shqipe në administratën shkollore. Veprimtari i kauzës shqiptare dhe ish i burgosur politik, Xun Çeta, në kumtesën e tij "Viti 1968, njëri ndër vitet historike të lëvizjeve në shekullin tonë", pos të tjerash, thotë se Demonstratat e vitit 1968 janë dy herë historike: e para, sepse ato imponuan fillimin e ndryshimeve pozitive dhe, e dyta, sepse ato vetvetiu janë mesi i të gjitha ngjarjeve dhe ndryshimeve pozitive që ndodhën pas vitit 1968.

Prof. dr. Zenun Gjocaj (tashmë i ndjerë ), ish i burgosur politik,

# ITËN JUGOSLLAVINË E TITOS




në kumtesën e tij "Rrethanat kulturore-politike të kohës së Demonstratave më 1968 në Kosovë", ndër të tjera, thotë se Demonstratat e vitit 1968 ishin rrjedhim i aspiratave kombëtare për çlirim, sidomos që nga copëtimi i Shqipërisë etnike...

Myrvete Dreshaj-Baliu, në kumtesën e saj "Konceptet politike të Jusuf Gërvallës mes ideologjisë dhe lirisë" thotë se Jusuf Gërvalla në shkrimet dhe letërkëmbimin e tij me veprimtarët e Lëvizjes ilegale, ndër të tjera, shkruante: "Gjaku i derdhur, burgu i zi dhe terrori çnjerëzor që po ushtrohet në bijat dhe bijtë e Kosovës trime, na obligon që atdheut tonë t'i dalim hakut me një dashuri që bëhet, siç thotë Kadareja, me ngut, me alarm, me përpjekjet mbinjerëzore të luftëtarëve të vërtetë të lirisë" .

Historiania Sabile Keçmezi-Basha, në kumtesën e saj "Karakteri kombëtar i programit të Demonstratave të vitit 1968" thotë se në këto demonstrata njëzëri u kërkua që popullit shqiptar të Kosovës t'i njihej statusi i kombit, ndërsa Krahinës së Kosovës t'i njihej statusi i Republikës. Drejtori i Institutit të Historisë, historiani Sabit Syla, në kumtesën e tij "Qëndrimi i shtetit shqiptar ndaj Demonstratave në Kosovë më 1968", ndër të tjera, thekson se udhëheqja e PPSH-së dhe e shtetit shqiptar më 1968, nëpërmjet luftës së saj, me karakter të theksuar ideologjik, denoncoi dhe demaskoi udhëheqjen jugosllave për shtypjen e shqiptarëve në Jugosllavi. Ajo mbrojti të drejtat e popullit shqiptar dhe ndihmoi kauzën e tyre për afirmim kombëtar. Sylë Kuçi, aktivist i njohur e pjesëmarrës i drejtpërdrejtë i Demonstratave të Pejës, në kumtesën e tij "Historia e një vjeshte", duke i kujtuar këto demonstrata, ndër të tjera, shkruan edhe këto: Vonë pas mesnate, trokiti dera e katit. Sylë Kuçi kishte ardhur ta arrestonte Sylë Kuçin! Çfarë ironie! Më tha shkurt: "Djali i bacës, poshtë është kryeshefi. Nëse do me ardhë, eja. Prej këtu të marr unë dhe këtu të kthej unë. Nëse nuk do, sonte s'të prek kush, por këta nuk e lanë pa e ba të veten". Kushëriri im, Syla, inspektor i Sigurimit të shtetit, njihej si njeri i fjalës, prandaj pa hezitim u nisa. Në të dalë, në derë të katit, dëgjova një zë nga errësira: "Këqyr, more, mos fëlliq gja atje!" Syla ia ktheu: "Hajt, baca Zenun, mos ki dert ..."

Analisti i njohur e veprimtar i Lëvizjes ilegale në Perëndim, Shaban Sinani, në kumtesën e tij "Brezi 1968, si u njoh në Tiranë", ndër të tjera, shkruan: "Ashtu si "Brezi 1968" në Evropë e gjetiu shembi status quo-në dhe imponoi një moral të ri politik, ashtu edh "Brezi 1968" në Kosovë tronditi rendin kushtetues jugosllav. Në Tiranë u krijuan drejtori, sektorë dhe shërbime të posaçme, që kishin për detyrë të njihnin situatën që zhvillohej në Kosovë, të vlerësonin ngjarjet, të mbanin lidhje me organizatat politike ilegale shqiptare në ish-Jugosllavi e në mërgim, për hartimin e një strategjie politike kombëtare..."

Historiani Sheradin Berisha, në kumtesën e tij "Roli historik i Demonstratave shqiptare të vitit 1968", ndër të tjera, thekson se Demonstratat e vitit 1968 patën një rol të madh në zhvillimet e mëvonshme politike. Ato e detyruan udhëheqjen jugosllave të rishqyrtojë statusin juridik të Kosovës.

Mr. Sheremet Krasniqi (autor i këtij shkrimi), në kumtesën e tij "Konferenca vjetore e studentëve të Fakultetit Filozofik të Prishtinës për Demonstratat e 68-s", duke folur për këtë konferencë të studentëve, të mbajtur në Amfiteatrin e Madh të këtij fakulteti, të mbushur përplot studentë e të ftuar të tjerë nga Komiteti Krahinor, në mesin e të cilëve ishin edhe Veli Deva, Mahmut Bakalli, Ismajl Bajra e shumë funksionarë të tjerë, paraqet fjalën e tij në këtë konferencë dhe atmosferën që mbretëroi, atëbotë, në të. Ai, ndër të tjera, i thotë edhe këto: "Këto demonstrata ishin aq madhështore, sepse me to për herë të parë ia dridhnim truallin nën këmbë Jugosllavisë "së painkuadruar" të Titos, e cila jashtë shitej si vendi më demokratik në botë. Për to është folur e është shkruar shumë, por mendoj se askush nuk mund t'i paraqesë më mirë, në dritën e së vërtetës, se ne pjesëmarrësit e drejtpërdrejtë të këtyre demonstratave. Madje një historian yni (Skënder Rizaj) ka deklaruar se demonstratat e 68-s janë organizuar me lejen e Titos e të Millosh Miniqit!". Madje, gjenerali i famshëm, Kudusi Lame, ish-komandant i Divizionit të Kukësit të Forcave të Armatosura të Shqipërisë, i cili e ndihmoi shumë luftën e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, kur dëgjoi këto nga goja ime, e mori fjalën dhe foli për rëndësinë historike të këtyre demonstratave dhe, pos të tjerash, i tha edhe këto radhë: "Të shkruhet e të thuhet se këto demonstrata janë organizuar me lejen e Titos e të Millosh Miniqit kjo është çmenduri! Ata që shkruajnë kështu le të shkojnë në Beograd dhe atje le të shkruajnë e të thonë ç'të duan për këto demonstrata!"

Shkodran C. Imeraj, në kumtesën e tij "Kontributi i të rinjve nga komuna e Deçanit në demonstratën e vitit 1968 në Pejë", ndër të tjera, shkruan se vatër e organizimit të demonstratës së vitit 1968 në Pejë ishte shkolla normale "Ali Kelmendi". Demonstratat e 6 dhe 8 tetorit 1968 në Prizren dhe Suharekë ishin paraprijëse të demonstratës së 19 tetorit 1968 në qytetin e Pejës. Në këtë demonstratë edhe nxënësit nga komuna e Deçanit me rrethinë dhanë një kontribut të rëndësishëm.

Kumtesa e fundit e këtij vëllimi është kumtesa e atdhetarit të njohur Shaqir Salihu, i cili tash jeton në Amerikë. Ai, në kumtesën e tij "Letër përshëndetëse nga Amerika" , ndër të tjera, shkruan se ato ditë zgjojnë në mua ndjenjën e krenarisë për liri, pavarësi e bashkim kombëtar, ashtu siç ishte Lëvizja Kombëtare Shqiptare që nga viti 1912 e deri në luftën fitimtare të UÇK-së më 1997-2001.

*Të nderuar të pranishëm,*
*Më lejoni t'i them edhe këto radhë:*

Mendoj se këto 25 kumtesa të këtij vëllimi dhe 28 të vëllimit I, që sot po e shohin dritën e botimit, do të përmbushin një boshllëk, që i ka munguar historiografisë sonë. Ndërsa kumtesat e tjera të këtyre Demonstratave, që kanë mbetur pa u botuar, që mendohet të përfshihen në vëllimin III e IV, presin ditë më të mira, sepse nuk ka kush t'i përgatisë për shtyp: mjete nuk ka e falas s'po i merr në duar askush. Edhe këto dy vëllime, që sot po e shohin dritën e botimit, u vonuan 10 vjet, për shkak të mungesës së mjeteve.

Se ç'rrezik paraqitnin për Jugosllavinë kërkesat e atëhershme të studentëve e të popullatës shqiptare dëshmon edhe kjo deklaratë e shkrimtarit të njohur e akademikut fashizoid serb, Millosh Cërnjanski: "Nuk e kuptoj pse hapni fakultete në Prishtinë! Çdo shqiptar i shkolluar është një armik më shumë për Jugosllavinë" .

*Të nderuar pjesëmarrës,*

Krejt në fund, dua t'jua bëj me dije edhe një fakt, edhe pse ndonjëri prej jush do të ma shohë për të madhe:

Barrën kryesore në botimin e këtyre librave të demonstratave të '68-s e të '81-shit e kanë bartur redaktori shkencor, prof. dr. Zymer Neziri, redaktori përgjegjës, prof. Meriman Braha dhe unë në cilësinë e lektorit e të sekretarit të Redaksisë, duke mos përjashtuar këtu as kontributin e Këshillit Organizues dhe të Këshillit Redaktues.




Sport

QENDRA SPORTIVE
"BUJQËSIA"
TEL: 045/82 82 82

# Feronikeli beson në kualifikim

Kampionët e Kosovës janë të gatshëm ta mposhtin sot Slovan Bratislavën dhe të kualifikohen në rrethin e tretë të Ligës së Evropës. "Besoj shumë se në ndeshjen e kthimit të kemi përkrahje të madhe dhe do të luajmë për fitore dhe kualifikim. Nuk kemi çfarë të kalkulojmë. Fitorja është obligimi ynë në ndeshjen që e luajmë si vendës", ka thënë Mevlan Zeka. Ndeshja fillon në orën 18:00



EPOKA E RE Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 29 KORRIK - Feronikeli është i gatshëm për ndeshjen e kthimit të rrethit të dytë në Ligën e Evropës ndaj Slovan Bratislavës. Skuadra kampione e Kosovës e humbi ndeshjen e parë me rezultat 2-1 në Sllovaki, por tash kjo skuadër po synon ta përmbysë këtë rezultat dhe të kualifikohet në rrethin e tretë të kësaj gare. Sulmuesi Mevlan Zeka ka thënë se shanset e skuadrës së Kosovës janë të mëdha që të kualifikohet tutje. "Kemi pasur paraqite të mirë ndaj një skuadre të fortë siç është Slovani, e cila ka përvojë të madhe në ndeshjet ndërkombëtare. Asgjë nuk është e pamundur, sepse tash të gjithë dinë të luajnë futboll. Besoj shumë se në ndeshjen e kthimit të kemi përkrahje të madhe dhe do të luajmë për fitore e kualifikim. Nuk kemi çfarë të kalkulojmë dhe fitorja është obligimi ynë në ndeshjen që e luajmë si vendës", ka thënë Zeka për gazetë.

Futbollist i Slovan Bratislavës, Joeri De Kamps, e pranon se mikpritja nuk do të jetë e mirë në Prishtinë pas gjithë asaj që ka ndodhur në Sllovaki, por paralajmëron se në Kosovë kanë ardhur me synim për t'u kualifikuar tutje. "E di që nuk do të pritemi mirë këtu pas asaj që ka ndodhur në Sllovaki. Mendoj se Feronikeli do ta ketë më të lehtë në këtë aspekt, por ne do të mundohemi ta luajmë lojën tonë. Në ndeshjen e parë nuk kemi pasur paraqitje të mirë ashtu siç kemi pritur. Si do që të jetë, ne nuk do të frikësohemi dhe do të kërkojmë kalimin në rrethin tjetër", ka thënë De Kamps.

Feronikeli është pjesë e Ligës së Evropës, pasi në Ligën e Kampionëve është eliminuar nga The New Saints e Uellsit, pasi në ndeshjen e parë luajti me rezultat 2-2, kurse në ndeshjen e kthimit pësoi humbje në "Fadil Vokrri" me rezultat 0-1. Për ndeshjen që zhvillohet sot në Prishtinë kanë paralajmëruar organizim të madh edhe tifozët e Feronikelit, "Tigrat e Zi". Kjo ka ardhur pasi në ndeshjen e parë të zhvilluar në Sllovaki, tifozët vendës të Slovanit nuk janë treguar aspak miqësorë me Feronikelin, pasi kanë shfaqur banderola me mbishkrimin se Kosova është Serbi. Kjo i ka irrituar "Tigrat e Zi", të cilët kërkojnë mbështetjen e të gjithë tifozëve shqiptarë. "Të gjithë për 'Niklin', të gjithë për Shqipërinë. Kosova është Shqipëri", thuhet në njoftimin e "Tigrave të Zi".

### Sot dalin në shitje biletat për ndeshjen Feronikeli - Slovan

Sot (e martë) në stadiumin "Fadil Vokrri" në Prishtinë Feronikeli zhvillon takimin kthyes për kualifikime të Ligës së Evropës ndaj Slovan Bratislavës. Biletat për këtë ndeshje dalin në shitje të martën nga ora 9:00. Biletat shiten në dy pika te stadiumi "Fadil Vokrri", kurse biletat gjenden edhe në restorant "Diamant" në Drenas dhe Pizzeria "Diamant" në Komoran. Ashtu si në ndeshjen e fundit, edhe për këtë takim do të ketë mijëra bileta falas. Çmimet e biletave për veri dhe jug janë nga 3 euro, për lindje çmimi i tyre është 5 euro, derisa për përmendim 10 euro. Në zonën VIP biletat kushtojnë 15 euro.

## SHKURT

### Më 31 korrik shorti për kampionatin e ri

Më 31 korrik në zyrat e Federatës së Futbollit të Kosovës do të bëhet tërheqja e shortit për kampionatin e ri për IPKO Superligë dhe për Ligën e Parë. Shorti për elitë do të tërhiqet në orën 13:00, derisa gjysmë ore më vonë do të bëhet edhe tërheqja e shortit për Ligën e Parë. Kampionati i ri në Superligë do të nisë më 17 gusht, ndërkohë klubet e Ligës së Parë garat do t'i nisin më 24 gusht.

### Sinani nga Llapi në Ballkan

Skuadra e Ballkanit vazhdon të përforcohet për edicionin e ri në IPKO Superligën e Kosovës në futboll. Skuadra e drejtuar nga Ismet Munishi ka arritur marrëveshje me mbrojtësin Egzon Sinani, i cili sezonin e fundit ishte pjesë e Llapit. "Qendërmbrojtësi Egzon Sinani ka ndërruar ngjyrat, nga ato blu të KF Llapit ka vendosur të vishet portokall, duke nënshkruar kontratën dyvjeçare me FC Ballkani. Egzoni shquhet me mentalitet fitues, këmbëngulës dhe insistues", thuhet në njoftimin e klubit nga Suhareka.

### Kloppi: Shaqiri do të luajë ndaj Lyonit

